Programi P01110	Paga + Sigurime	Shpenzime Operative	Transferta	Investime	Totali
Plani 4-mujorin e parë	40,689	17,378	3,442	32,753	94,262
Realizimi 4- mujorin e parë	26,215	7,498	547	7,394	41,654
Diferencë	14,474	9,880	2,895	25,359	52,608
Realizimi në %	64 %	43 %	16 %	22 %	44%



Realizimi i programit Planifikim, Menaxhim dhe Administrim në total është 44 % konkretisht :

- shpenzime për paga dhe sigurime është realizuar në masën 64 %.
- shpenzimet operative janë realizuar në masën 43 %.
- shpenzime për transferta janë realizuar 16 %.
- shpenzimet kapitale janë realizuar në masën 22 %.

Krahasuar me 4-mujorin e vitit 2021 pagat dhe sigurimet e personelit kanë një përqindje më të vogël realizimi sepse për vitin 2021 kemi pasur vende vakante 6 por për 2022 janë 10 vende vakante.

❖ Detajimi i shpenzimeve operative për programin “Planifikim, Menaxhim dhe Administrim” 1110

Shpenzimet operative janë realizuar me 43 % kjo për shkak se:

- Shpenzime interneti është lidhur kontrata por nuk janë prerë fatura .
- Ekzekutim vendime gjyqësore janë depozituar pranë zyrës së financës 3 subjekte të formës së prerë gjatë muajit prill dhe nuk ka filluar likuidimi i tyre .
- Blerje kancelari nuk është prokuruar .
- Larje e automjeteve të Bashkisë nuk është prokuruar .
- Materiale promovuese për turizmin nuk është prokuruar .
- Blerje dosje dhe kuti për ruajtje të perhereshme , arkiva nuk është prokuruar .
- Shërbim e mirëmbajtje Programit të Financës dhe Taksave Vendore nuk është prokuruar .
- Blerje materiale për riparime të sistemit të kamerave nuk është prokuruar .
- Blerje dhe vendosje tabela informuese dhe imazhe murale në ambientet e brendshme të Bashkisë nuk është prokuruar .
- Blerje goma + pjesë xhenerike, mirëmbajtje mjeteve kontrata përfundon në tetor 2022 .

Nr.	EMERTIMI I SHPENZIMEVE	Kap	Toali Vjetor	Shtesa	Paksime	Totali me ndryshime	Fakti Janar- Prill
1	Shpenzime për energji për Bashkinë dhe Njësite ,Ndricimi rrugor+ lidhje të reja	1	10,000			10,000	2,130
2	Shpenzime për ujësjellësin	1	350			350	112
3	Shpenzime për internetin	1	650		35	615	-
4	Shpenzime telefonike	1	350			350	15
5	Blerje Shtypshkrime	1	800			800	56
6	Blerje Kancelari	1	1,250			1,250	-
7	Siguracion ndërtesash	1	500			500	499
8	Taksa e mjeteve të Bashkisë	1	110			110	42
9	Siguracion makinash	1	102			102	19
10	Shpenzime për postën	1	2,150			2,150	450
11	Udhëtime e dieta jashtë vendit	1	700			700	62
12	Udhëtime e dieta brenda vendit	1	500			500	66
13	Regjistrim i pasurive në ZRVP të tjera mardh me inst shtetërore	1	1,000			1,000	38
14	Barrë hipotekore dhe sekuestro mbi pasuritë e paluajtshme	1	70			70	-
15	Shpenzime për Këshilltarë + Kryepaq	1	6,100			6,100	1,936
16	Egzekutim Vendime Gjyqësore	1	3,000			3,000	-
17	Blerje Karburant	1	3,024			3,024	656
18	Blerje goma + pjesë xhenerike,mirëmbajtje mjetes	1	1,000			1,000	-
19	Kontribut i shoqatës së Bashkive	1	450			450	-
20	Larje e automjeteve të Bashkisë	1	200			200	-
21	Blerje kartolina e kalendar	1	120			120	-
22	Blerje fishek zjarre	1	300			300	-
23	Shpenzime pritje përcjellje + dhurata me simbolet e bashkisë	1	300			300	61
24	Hostimi i faqes internetit	1	50			50	-
25	Materiale promovuese për turizmin	1	250			250	-
26	Panairi "Festa e mjalit "	1	750			750	-
27	Shërbim e mirëmbajtje Programit të Financës dhe Taksave Vendore	1	500			500	-
28	Blerje dosje dhe kuti per ruajtje te perhereshme , arkiva	1	435			435	-

29	Blerje materiale higjeno sanitare	1	100			100	-
30	Shpenzime per perkthim ,noterizim te projekteve te fituara nga fondet e BE-së	1	100			100	-
31	Mbushje kondicionere me gaz ne ambientet e bashkise Librazhd dhe Njesite Administrative	1	175			175	-
32	Riparim pakete dhe mbushje me gaz kondicioneri I salles se sherbimeve ADISA,tip ideclima	1		35		35	30
	Të trashëguara nga viti 2021						
32	Mirembajtje e Sistemit te Taksave Vendore	1	32			32	32
33	Blerje karburant	1	526,888			526,888	526,720
34	Blerje goma pjese xhenerike dhe mirembajtje mjetesesh	1	285			285	-
35	Blerje fishekzjarre	1	198			198	198
36	Vendime gjyqesore	1	300			300	-
37	Shpenzime postare	1	287			287	287
38	Blerje kalendar e kartolina	1	186			186	-
39	Kontribut i shoqatës së Bashkive	1	450			450	-
40	Shpenzime telefoni	1	5			5	5
41	Blerje motorrsharre per prerjen e druve te zjarrit	1	100			100	100
42	Shpenzime per abonim reviste/gazete	1	25			25	-
43	Shpenzime per studime te ndryshme per projektet /investimet	1	1,000			1,000	110
44	Blerje dhe vendosje tabela informuese dhe imazhe murale ne ambientet e brendeshme te Bashkise	1	370			370,	-
45	Blerje materiale per riparime te sistemit te kamerave	1	275			275	-
46	Patinim dhe lyerje zyra para zyres kryetarit dhe zyra e kryetarit	1	70			70	66
	TOTALI I SHPENZIMEVE		39,496	35	35	39,496	7,498

Krahasuar me vitin 2021 shpenzimet operative janë rritur me 7.2% sepse mosrealizimi në masën 20% në fund të vitit është trashëguar për vitin buxhetor 2022,qjithashtu janë shtuar shpenzime për studime të ndryshme për projektet /investimet, shpenzime per perkthim ,noterizim te projekteve te fituara nga fondet e BE-së etj...

❖ *Realizimi i investimeve për programin” Planifikim, Menaxhim dhe Administrim”*

Shpenzimet kapitale janë realizuar me 22 % kjo për shkak të disa kontratave të cilat nuk janë realizuar dhe konkretisht është :

- Mbikqyrje kolaudime nuk janë realizuar për shkak të mos përfundimit të kontratave ose neglizhenca e operatorëve fitues të cilët nuk presin faturat.
- Studime projekte për vitin 2021 pa prokuruar .
- Blerje paisje profesionale për kuzhinat e kopshteve pa realizuar.
- Blerje mobilie të ndryshme për zyrat e Bashkisë Librazhd 2021 prokuruar në shkurt 2022 likuiduar në majsi dhe blerje mobilie të ndryshme për zyrat e Bashkisë Librazhd për vitin 2022 pa prokuruar.
- Furnizim vendosje konfiguracion metalik me ndertim "I ♥ LIBRAZH" pa prokuruar.
- Blerje paisje elektronike pa prokuruar.
- Arredimi i sallës së keshillit Bashkia Librazhd pa prokuruar.
- Blerje automjet fouristrad 4x4 për Bashkinë Librazhd pa prokuruar.
- Rikonstrukcion i shkallevë hyrës të bashkisë Librazhd pa prokuruar.

Kodi projektit	Emertimi i projektit	Vlera e plotë	Viti i fillimit	Viti i përfundimit	Buxheti	Plani i buxhetit viti 2022	Realizimi për periudhën e raportimit Janar- Prill 2022	Komente
			të	të				
			projektit	projektit	Kontraktuar			
01110	Planifikim Menaxhim Administrimi	49,338,617			42,029,711	38,971,029	7,394,586	
1	Mbikqyrje kolaudime viti 2022	5,000,000	2022	2022	5,000,000	5,000,000		Pa prokuruar
2	Furnizim vendosje konfiguracion metalik me ndertim "I ♥ LIBRAZHD"	500,000	2022	2022	500,000	500,000		Pa prokuruar
3	Blerje paisje elektronike	600,000	2022	2022	600,000	600,000		Pa prokuruar
4	Blerje mobilie te ndryshme per zyrat e Bashkise Librazhd	500,000	2022	2022	500,000	500,000		Pa prokuruar
5	Studime projekte	3,000,000	2022	2022	3,000,000	3,000,000		Pa prokuruar
6	Bashkëfinancim permirsimi i banesave ekzistuese per komunitetet e varfera dhe te pafavorizuara per vitin 2021	8,311,197	2021	2022	7,719,437	3,979,397	3,780,427	Perfunduar ,likujduar
7	Arredimi i salles se keshillit Bashkia Librazhd	4,558,000	2022	2022	4,558,000	4,558,000		Pa prokuruar
8	Blerje automjet fouristrad 4x4 per Bashkine Librazhd	3,500,000	2022	2022	3,500,000	3,500,000		Pa prokuruar
9	Kolaudim "Rikonstruksion dhe rehabilitim I pallatit te kultures ne Librazhd	72,000	2021	2021	72,000	72,000	72,000	Perfunduar ,likujduar
10	Mbikqyrje Ndertim Central Park (parku Qendror)	660,133	2021	2021	660,133	660,133		Pa prokuruar
11	Mbikqyrje Disiplinim I ujrave te bardha ne pjesen veriore te bibliotekes Librazhd	84,625	2021	2021	84,625	84,625		Pa prokuruar
12	Mbikqyrje Izolimi I soletes se shkolles 9-vjecare "V.Blloshmi"	16,475	2021	2021	16,475	16,475		
13	Kolaudim Rikonstruksion i kanalit vadites te Mesit,Gizavesh, Dorez, Librazhd	173,455	2021	2021	173,455	173,455		
14	Kolaudim Izolimi i soletes se shkolles 9-vjecare Vilson blloshmi	2,640	2021	2021	2,640	2,640		
15	Mbikqyrje "Punime ne rrugen e lagjes Vasku per eliminim rreshqitje fshati Hotolisht NJ.Adm.Hotolisht Bashkia Librazhd	16,800	2021	2021	16,800	16,800		
16	Kolaudim Disiplinim I ujrave te bardha ne pjesen veriore te bibliotekes Librazhd	13,200	2021	2021	13,200	13,200		Pa prokuruar
17	Mbikqyrje Permisimi i banesave ekzistuese per komunitetet e varfera dhe te pafavorizuara	377,298	2021	2021	377,298	377,298		
18	Kolaudim Punime ne rrugen e lagjes Vasku per eliminim rreshqitje ,fshati Hotolisht ,Nj.Adm.Hotolisht,Bashkia Librazhd.	2,040	2021	2021	2,040	2,040		

19	Bashkefinancim Permisimi i banesave ekzistuese per komunitetet e varfera dhe te pafavorizuara per vitin 2021	8,311,197	2021	2022	7,719,437	2,774,509	2,635,784	Perfunduar ,likujduar
20	Instalim I programit te finances dhe kontabilitetit per D.M.f dhe Zhvillimit Ekonomik	72,000	2020	2020	72,000	72,000	72,000	Perfunduar ,likujduar
21	Rehabilitim, perforcim banesash ekzistuese dhe rikonstruksion qendra e fshatit TogeZ 2019	366,076	2019	2019	366,076	366,076	347,772	Perfunduar ,likujduar
22	Kolaudim "Ndertim ujesjellsi Hotolisht Fshat Nj.Hotolisht dhe fshati Merqiz , Lagje Spathar , Nj.Qender .	198,000	2019	2019	198,000	198,000		
23	Kolaudim "Riparim lere betoni e plasmasi	7,800	2020	2020	7,800	7,800		
24	Kolaudim "Ndertim ure tip beli mbi lumin Shkumbin Rrethi Bardhe	27,000	2020	2020	27,000	27,000		
25	Kolaudim " Ndertim vepra rugore dhe ujore ne Njesite Administrative te Bashkise "	20,400	2020	2020	20,400	20,400		
26	Mbikqyrje Rikonstruksion I rruges se fshatit Hotolisht dhe kthesa Xhyre	164,095	2020	2020	164,095	164,095		
27	Mbikqyrje "Rikonstruksion i kanalit vadites te Mesit ,Gizavesh,DoreZ,Librazhd "	1,293,836	2020	2020	794,736	794,736		
28	Kolaudim "Riparime te pjeshme emergjente ne kanalet vaditese 2020"	3,170	2020	2020	3,170	3,170		
29	Mbikqyrje Shtese Kontrate Rikonstruksion I rruges se fshatit Hotolisht dhe Kthesa e Xhyres ,Nj.Hotolisht	26,400	2020	2020	26,400	26,400		
30	Kolaudim Rikonstruksion I oborrit dhe punimeve ne hollin e shkolles se mesme I.Muca	13,200	2020	2020	13,200	13,200	13,200	Perfunduar,likujduar
31	Kolaudim " Rikonstruksion I shkolles 9-vjecare Orenje	11,234				11,234		
32	Kolaudim Shtese Kontrate Rikonstruksion I rruges se fshatit Hotolisht dhe kthesa e Xhyres Nj.Adm Hotolisht	3,600	2021	2021	3,600	3,600		
33	Kolaudim Rikonstruksion I rruges se fshatit Hotolisht dhe kthesa e Xhyres Nj.Adm Hotolisht	21,600	2021	2021	21,600	21,600		
34	Kolaudim "Punime per nderhyrje dhe riparime te detyruara ne rruget rurale te demtuara nga rreshqitjet	4,200	2021	2021	4,200	4,200	4,200	Perfunduar,likujduar
35	Kolaudim Ndertim shkolla 9-vjecare vartese Sebishte Nj.Adm Stebleve	6,000	2021	2021	6,000	6,000		
36	Blerje dhe montim kondicioner kollone 60.000 btu per sallin e keshillit Bashkiak	366,000	2021	2021	366,000	366,000	366,000	Perfunduar,likujduar
37	Blerje paisje profesionale per kuzhinat e kopshteve	760,800				760,800		

38	Detyrime te prapambetura	757,244				648,609		
39	Rehabilitim, perforcim banesash ekzistuese dhe rikonstrukcion qendra e fshatit TogeZ 2019					108,635	103,203	Perfunduar ,likujduar
40	Studime projektme	4,000,000	2022	2022	4,000,000	4,000,000		
41	Blerje mobilie te ndryshme per zyrat e bashkise Librazhd	500,000	2022	2022	500,000	500,000		
42	Rikonstrukcion I shkalleve hyrese te bashkise Librazhd	889,894	2022	2022	889,894	889,894		Pa prokuruar
43	Blerje frigorifer per administraten e bashkise	30,000	2022	2022	30,000	30,000		
44	Shtese fondi sipas v.k.b nr.25 dt.29.03.022 Rikualifikimi I qendres se fshatit Fushe Studen dhe ndertimi I shtegut te bicikletave	4,097,008	2022	2022	4,097,008	4,097,008		Pa prokuruar

Aparati i Bashkisë ka si objektiv formalizimin, përmirësimin e punës, shërbimeve administrative dhe rritjen e transparencës.

Për vitin 2022 në programin “ Planifikim, Menaxhim dhe Administrim” në funksion të veprimtarisë kryesore dhe përmbushjes së objektivave të përcaktuara për vitin 2022, janë analizuar si më poshtë:

01. Mbështetje për funksionimin e organeve të zgjedhura vendore (Këshilli i Bashkisë dhe Kryepleqtë).

Është realizuar shpërblimi mujor në mënyrë sistematike dhe me korrektësi për anëtarët e këshillit bashkiak dhe kryepleqtë e njësive administrative.

02. Kuota e anëtarësisë për financimin e buxhetit të qarkut planifikuar qershor,shtator, në vazhdimësi.

Realizohet gjatë vitit transferimi dhe permbushja e detyrimit ne baze te ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore“, e pa realizuar trashëguar në buxhetin e vitit 2022.

03.Vazhdimësia e menaxhimit efektiv e administratës së Bashkisë Librazhdit në funksion të përmbushjes së misionit, qëllimeve dhe objektivave dhe përgjegjësi të Bashkisë së Librazhdit për ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.

Kemi realizuar sigurimin e mbështetjes së funksionimit të administratës së Bashkisë Librazhdit përmes realizimit në kohë të shpenzimeve për paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësore. Mbështetje e strukturës funksionale me 107 punonjës . Plotësim sipas nevojës dhe rekrutimi i personelit të administratës vendore në mënyrë transparente, me profesionalizëm dhe në bazë të meritave, aftësive profesionale, pavarësisë dhe integritetit, vazhdimësisë së karrierës, përgjegjësisë dhe korrektesës dhe në zbatimin e ligjeve:

Zbatimi i buxhetit për shpenzime personeli u bazua tek numri i punonjësve dhe nivelet e pagave sipas klasave e shtesave mbi pagë në përputhje me aktet nënligjore në fuqi, brenda kufirit minimal dhe maksimal të miratuar. Paga, shtesat mbi pagat e punonjësve bëhen sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.165 datë 02.03.2016 ”Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, VKM nr. 717, datë 23.6.2009, të Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore” të ndryshuar; VKM nr. 187, datë 8.3.2017 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrave të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit”; i ndryshuar. Kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore u bazua në zbatim të ligjit Nr. 7703, datë 11. 05. 1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e

Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të ligjit Nr. 7870, date 13. 10. 1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”.Realizuar rregullisht.

O4. Rekrutimi i burimeve njerëzore në funksion të përmbushjes së misionit, qëllimeve dhe objektivave të Bashkisë së Librazhd për orfrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve

Ky aktivitet synon rekrutimin e burimeve profesionale për të qenë pjesë e administratës vendore përmes procedurave të përcaktara me ligj, në mënyrë transparente, me profesionalizëm dhe në bazë të meritave, aftësive profesionale, pavarësisë dhe integritetit, vazhdimësisë së karrierës, përgjegjësisë dhe korrektesës në zbatimin e ligjeve. Këto rekrutime realizohen me procedurën e lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese dhe pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive. Kjo procedurë realizohet përmes konkursit të hapur në zbatim të Ligjit Nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, VKM Nr. 242, datë 18/03/2015, VKM Nr. 243, datë 18/03/2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”. Konkurrimi ndjek disa etapa, përfshirë ngritjen e Komisioneve të pranimit. Anëtarë të komisioneve të vlerësimit gjatë procesit të rekrutimit janë edhe punonjës të nivelit drejtues të administratës publike vendore si dhe ekspertë jashtë institucionit të Bashkisë Librazhd .

O5. Trajnimi i burimeve njerëzore të Bashkisë së Librazhdit

Ky aktivitet synon që nëpunësit civilë për përfitimin dhe përditësimin e njohurive shtesë të mund të kryejnë trajnime në institucione të tjera trajnuese me inisiativën e tyre, për detyrën që ata kryejnë, me propozimin e përbashkët të eprorit e të drejtuesit të njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit dhe me miratimin e titullarit të institucionit.

O6. Mbështetja dhe ofrimi i shërbimeve bazë për funksionimin administratës së Bashkisë së Librazhd.

Është përmirësuar funksionimi normal i të gjithë administratës së Bashkisë së Librazhd nëpërmjet ofrimit të shërbimeve mbështetëse bazë si ujë, energji elektrike, ngrohje, komunikim postar, shërbim telefonie etj. Realizuar me sukses në vazhdimësi .

O7. Shërbim me kancelari dhe shtypshkrime për administratën e Bashkisë së Librazhdit

Është planifikuar shërbimi me kancelari, letër, bojë, shtypshkrime etj për t’iu mundësuar punonjësve përmbushjen e detyrave administrative për të gjithë administratën, por për vitin 2022 ky shpenzim nuk është prokuruar akoma dhe mbetet i përpunuar gjë e cila sjell vështirësi në punë.

O8. Mbështetje dhe ofrim i shërbimit të transportit për funksionimin e administratës së Bashkisë së Librazhd.

Realizuar blerja e karburantit dhe furnizimi sistematik me karburant i mjeteve të transportit për kryerjen e detyrave dhe funksioneve të përditshme të administratës vendore të Bashkisë Librazhd sipas nevojave në qendër , njësi administrative etj. Realizuar në vazhdimësi.

Realizuar shlyerja e pagesës së sigurimeve, taksave të qarkullimit dhe kolaudimit vjetor të mjeteve të transportit në shërbim të administratës sipas rasteve .

O9. Nxitja dhe mbështetja e bashkëpunimit të biznesit, për zhvillimin dhe fuqizimin e tyre. Panairi i produkteve agroperpunuese sipas njësive administrative planifikuar për në muajin shtator “Festa e Mjaltit”.

10. Organizimi i pritjeve të përfaqësuesve të institucioneve vendase dhe të huaja

Organizimin e pritjeve përcjelljeve të delegacioneve përfaqësuesve dhe institucioneve vendase dhe të huaja me qëllim vendosjen e marrëdhënieve dypalëshe me shumë institucione homologe të huaja, në nivel lokal, rajonal dhe ndërkombëtar .

Realizuar me sukses në vazhdimësi .

O11. Udhëtime e dieta për administratën vendore në funksion të kryerjes së shërbimeve në punë.

Shërbimi për udhëtime e dieta për administratën vendore në funksion të kryerjes së shërbimeve në punë është i domosdoshëm në rritjen e standartit të plotësimit të kushteve të punës ndaj administratës si dhe anasjelltas, në rritjen e eficiencës së administratës për dhënien e kontributit dhe përfaqësimin e duhur të institucionit në takime pune, seminare, workshop-e brenda dhe jashtë vendi . Për realizimin e këtyre lëvizjeve është bërë rimbursimi i shpenzimeve dhe dietave për administratën vendore në masën financiare që ligji e parashikon.

O12. Sigurimi i ndërtesave administrative të Bashkisë së Librazhd realizuar me sukses.

O13. Shërbim i mirëmbajtjes për godinat administrative të Bashkisë së Librazhdit.

Janë përmirësuar kushtet në zyrat administratës vendore.

O14. Shërbim Interneti për Institucionin e Bashkisë së Librazhd.

Është realizuar në vazhdimësi ofrimi i shërbimit të internetit në të gjithë Bashkinë Librazhd dhe Njësitë Administrative .

O15. Mirëmbajtje Pajisje Informatike .Janë krijuar kushtet për mirëfunksionimin e paisjeve TIK.

O16. Mirëmbajtje e faqes zyrtare Web www.bashkialibrazhd.gov.al dhe moduleve të integruara të saj.

O17. Shërbimi për regjistrimin e pronave në pronësi të Bashkisë Librazhd.

Realizuar në vazhdimësi shërbimi për regjistrimin e pronave të transferuara në pronësi të Bashkisë Librazhd , i cili synon përmbushjen e detyrimeve që Bashkia Librazhd ka për regjistrimin e pronave të miratuara me Vendim të Këshillit të Ministrave me Nr.421, datë 02.06.2010 “Për miratimin e listës përfundimtare (të pjesshme) të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi apo në përdorim të Bashkisë Librazhd .

O18. Detyrime dhe kompensime legale. Realizuar në vazhdimësi .

Spektori Juridik ka perfaqesuar institucionin bashkine Librazhd në procese gjyqesore civile, administrative , në të cilën ka qënë palë në proces.

Janë depozituar pranë zyrës së financës 3 subjekte të formës së prerë gjatë muajit prill dhe nuk ka filluar likuidimi i tyre .

❖ NJËSIA E PROKURIMEVE PUBLIKE

Objektivat kryesore:

Objektiv 1

- Sigurimin e të dhënave të nevojshme nga strukturat përkatëse në institucion dhe përgatitjen e regjistrimit të parashikimeve për vitin 2022. Hedhja e të gjithë elementeve të regjistrimit të parashikimeve të prokurimeve Publike në sistemin elektronik të APP brenda afateve ligjore të parashikuara nga legjislacioni përkatës.

Objektiv 2

- Realizimin e të gjitha prokurimeve Publike të parashikuara në regjistër sipas afateve të përcaktuara.

Objektiv 3

- Përgatitja e shtesave dhe ndryshimeve të regjistrimit të parashikimeve të prokurimeve Publike gjatë vitit, hedhja në sistemin elektronik të APP.

Objektiv 4

- Nxitjen e pjesëmarrjes dhe konkurrencës, së operatorëve ekonomik në procedurat e prokurimit publik, duke përgatitur kriteret dhe dokumentat standarte të tenderit në përputhje me kërkesat ligjore.

Objektiv 5

- Bashkëpunimin mes zyrave të bashkisë për hartimin e specifikimeve, preventivave dhe kontrollit të tyre.

Objektiv 6

- Përgatitja e procedurës së prokurimit, duke filluar që nga urdhëri I prokurimit, përllogaritjen e fondit limit, hartimin dhe publikimin e njoftimeve për botim Brenda afateve ligjore, mbledhjen e të gjitha materialeve të nevojshme që u bashkalidhen dokumentave të tenderit (hartat, skicat, grafikun, planet etj).

Objektiv 7

- Kryerjen e inventarizimit të dosjeve të procedurave të prokurimit publik dhe dorëzimin e tyre në arkivin e Bashkisë.

Objektiv 9

- Mirpërdorimin e fondeve publike dhe uljen e shpenzimeve proceduriale.

Gjatë kësaj periudhe në Njësinë e prokurimit publik, është punuar për zhvillimin dhe realizimin e të gjitha procedurave të Prokurimit Publik të ardhura pranë zyrës së prokurimeve në bashkëpunim të ngushtë me të gjitha drejtoritë përkatëse dhe dërgimin e tyre për likuidim pranë Drejtorisë së Financës dhe Degës së Thesarit brenda afateve ligjore, një bashkëpunim me Drejtorinë e Financës që ka realizuar mjaft i suksesshëm pasi nuk kemi pasur asnjë procedurë prokurimi që është refuzuar nga Drejtoria e Financës apo dhe Dega e Thesarit.

Në disa procedura prokurimi kemi patur ankesa nga operatorët ekonomik për kriteret apo për vlerësimin nga komisioni i vlerësimit të ofertave, të gjitha keto të përkthyer në vonesa në kohe. Me hartimin e regjistrimit të parashikimeve për vitin 2022, është bërë një përmiresim pasi jemi munduar të ulim sa më shumë numrin e procedurave të Prokurimit duke i bashkuar shumë prej tyre në një element të vetëm duke ulur në këtë mënyrë kostot për Autoritetin Kontraktor. Gjatë gjithë vitit kalendarik 2022, janë

parashikuar si ze ne rregjistrin e parashikimeve te prokurimeve publike rreth 72 procedura , nga te cilat 7(shtatë) procedura jane ne vleren nen 100 000 leke pa tvsh, per te cilat perjashtohen nga procedurat e prokurimit publik dhe vetem deklarohen ne Sistemin e Prokurimit Publik nqs realizohen nga Sektori i Finances. Procedura prokurimi te realizuar ne total qe jane finalizuar me nenshkrimin e kontratave perkatese jane 12, proceduranë proçes janë 8 .

Programi 01170- Gjendja Civile

Ky program përfshin zyrat e gjendjes civile në Bashkinë Librazhd dhe në 7 Njësi Administrative ,gjithësej 6 punonjës.

Realizimi i qëllimit dhe objektivave të politikës së programit

Qëllimi i programit 01170:

- Gjendja Civile është sigurimi i një shërbimi sa më cilësor ndaj komunitetit për funksionet e deleguara.

Objektivi i programit është :

O1. Shërbime te deleguara të mbështetura për funksionimin e tyre.

Përshkrimi i programit

Fondet e pushtetit qëndror për funksionin e deleguar të gjendjes civile në njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Rezultatet e programit Gjendja Civile

					000/leke
Programi	Paga +	Shpenzime	Transferta	Investime	Totali
P 01170	Sigurime	Operative			
Plani 4-mujorin e parë	1,496				1,496
Realizimi 4-mujorin e parë	1,495		333		1,828
Diferencë	1				
Realizimi në %	100 %				100%

Realizimi i shpenzime për paga dhe sigurime është realizuar në masën 100 %.

Transfertat janë aktet e pullave nga Gjendja civile në vlerën 333 mijë lekë.

Për vitin 2022 në programin 01170 “ Gjendja Civile ” në funksion të veprimtarisë kryesore dhe përmbushjes se objektivave të përcaktuara është përmirësuar shërbimi i Gjendjes Civile.

O1.Shërbimet e deleguara Gjendja Civile

Është realizuar dhe përmirësuar rritja e të ardhurave të arkëtuara nga prodhimi i dokumentave dhe realizuar shkurtimi i kohës së marrjes së shërbimit.

FUNKSIONI : 03 RENDI DHE SIGURIA PUBLIKE

Nenfunkcioni 031: Shërbimet policore

Programi 03140: Shërbimet e Policisë Vendore

Administrimi i çështjeve dhe shërbimeve policore që janë të nevojshme për kryerjen e funksioneve në shërbim të rendit, qetësisë dhe mbarëvajtjes së punëve publike, parandalimin dhe zbulimin e informalitetit brenda territorit të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Sigurimi i mbrojtjes, qetësisë dhe mbarëvajtjes së jetës dhe punëve publike brenda territorit të njësisë, në përputhje me dispozitat ligjore, kur nuk janë në kompetencë të ndonjë autoriteti tjetër shtetëror;

Ekzekutimi dhe zbatimi i akteve të nxjerra nga Kryetari i Njësisë dhe i vendimeve të Këshillit të Njësisë;

Policia bashkiake kontribuon dhe ka funksion:

- Ruajtjen e rendit, të qetësisë dhe mbarëvajtjen e punëve publike brenda territorit të Bashkisë.
- Pjesëmarrjen aktive në dhënien në ndihmë të familjeve në nevojë.
- Sigurimin i mbrojtjes, qetësisë dhe mbarëvajtjes së jetës dhe punëve publike brenda territorit të njësisë, në përputhje me dispozitat ligjore, kur nuk janë në kompetencë të ndonjë autoriteti tjetër shtetëror;
- Ekzekutimin dhe zbatimin e akteve të nxjerra nga Kryetari i Njësisë dhe i vendimeve të Këshillit të Njësisë.

Sfidat:

- Nevojë për më shumë bashkërendim ndërmjet institucioneve, me Drejtorinë e Policisë së shtetit.
 - Duhet të shihet mundësia e lirit të trotuareve. Zaptohen trotualet nga bizneset.
- Njerëzit detyrohen të ecin në rrugë, dhe bëhet burim aksidenti. Në këto raste duhet të vepohet me forcë për lirin e hapësirave publike (trotuare). Trotualet bllokohen me fruta dhe perime nga ambulancet dhe njerëzit detyrohen të ecin në rrugë. Duhet të shihet me përparësi liri i hapësirave publike.

Qëllimi i Politikës së Shërbimit: Shërbim të rendit, qetësisë dhe mbarëvajtjes së jetës dhe punëve publike brenda territorit të bashkisë, në përputhje me dispozitat ligjore. Parandalimin e kundërvajtjeve administrative, forcimin, inspektimin dhe monitorimin e zbatimit të rregulloreve e të akteve të bashkisë dhe keshillit bashkiak brenda juridiksionit vendor dhe në përputhje me përcaktimet ligjore.

- Objektivat e programit buxhetor për përmbushjen e këtij qëllimi për vitin 2022 janë:

O1. Polici vendore e trajnuar dhe e kualifikuar për kryerjen e funksioneve dhe përgjegjësi.

O2. Rritja e qetësisë dhe mbarëvajtjes së jetës dhe punëve publike brenda territorit të njësisë, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Rezultatet e programit Shërbimet e Policisë Vendore

					000/leke
Programi P 03140	Paga + Sigurime	Shpenzime Operative	Transferta	Investime	Totali
Plani 4-mujorin e parë	2,610	343			2,953
Realizimi 4-mujorin e parë	1,671				1,671
Diferencë	939	343			1,282
Realizimi në %	64 %	0			56%

Realizimi i shpenzime për paga dhe sigurime është realizuar në masën 64 %.

Për vitin 2022 në Programin "Shërbimet Policore Vendore" në funksion të veprimtarisë kryesore dhe përmbushjen e objektivave të përcaktuara, janë parashikuar 4 aktivitete.

-Aktivitetet janë analizuar si më poshtë:

O1.Vazhdimësia e menaxhimit efektiv të Policisë Bashkiake në funksion të përmbushjes së misionit, qëllimeve dhe objektivave dhe përgjegjësi të Bashkisë Librazhd për ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.

O2. Mbështetje dhe ofrim i shërbimit të transportit për funksionimin e policisë Bashkiake .

O3. Blerje dokumentacioni shtypshkrime në funksion të policisë Bashkiake .

O4.Blerje rroba pune për punonjësit nuk është realizuar për shkak të refuzimit të mallit pasi nuk përmbushte specifikat e kërkuara .

Nënfunkcioni 032: Shërbimet e mbrojtjes nga zjarri

Programi 03280: Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile

Ky program përfshin institucione dhe konkretisht:

1. Sektorin e MZSH , gjithësej 16 punonjës.

Garantimi i shërbimit zjarrfikës në nivel vendor dhe administrimi i strukturave përkatëse; Parandalimi, mbrojtja nga zjarri dhe përbalimi i emergjencave të tjera që vijnë nga rreziqet natyrore ose aksidentet e trafikut rrugor.

Funksionimi i njësive zjarrfikëse dhe i shërbimeve të tjera të parandalimit dhe mbrojtjes kundër zjarrit;

Mbështetja e programeve trajnuese të parandalimit dhe mbrojtjes kundër zjarrit;

Shërbime të parandalimit dhe mbrojtjes kundër zjarrit;

Mbrojtja Civile dhe administrim i strukturave përkatëse; Shërbimet e mbrojtjes civile, si shpëtimet malore, evakuimi i zonave të përmytura etj.

Synimi dhe përpjekja jonë është fokusuar në:

- Zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë përmes aktivizimit të shërbimit të mbrojtjes civile.
- Përmirësimin e sigurisë publike në të gjithë territorin e Bashkisë Librazhd, duke siguruar informacion publik të vazhdueshëm për reziqet, aktivitetet e shërbimit të Bashkisë, me prioritet parandalimin e situatave që çenojnë sigurinë e jetës dhe pronës së qytetarëve, bizneseve, aseteve administrative, pasurive kulturore, natyrore, etj.
- Vlerësimin e dëmeve nga specialistët e ngarkuar me urdhër të brendshëm dhe përllogaritjet financiare të vlerësimit për dëmet e shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore.
- Hartimin dhe plotësimin e dokumentacionit për dhënien e ndihmës së menjëhershme për familjet me raste fatkeqësie.
- Kryerjen e kontrollit sistematik vjetor dhe çertifikimin për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimin të objekteve të Bashkisë sipas prioriteteve.
- Blerjen e fikseve automatike të zjarrit, rimbushjen e bombolave të fikseve automatike të zjarrit për objektet institucione publike në administrim të Bashkisë Librazhd.
- Rimbushjen e bombolave të fikseve automatike të zjarrit në shkolla, bombolave të fikseve automatike të zjarrit për rimbushje gjendje pranë MZSH-së, dhe në godinën e Bashkisë Librazhd për përdorim në rast emergjence.
- Trajtimin dhe vlerësimin e akteve teknike për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimin për objektet.
- Shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin për popullsinë: Shërbimi i MNZSH-së, është strukturë e specializuar e gatishmërisë së përhershme. Kjo strukturë ka kryer inspektimin, parandalimin, me masat e mbrojtjes nga zjarri, ndërhyrje për shuarjen e zjarreve, shpëtimin e jetës, gjësë së gjallë, pronës, mjedisit, pyjeve dhe kullotave, ndërhyrje në aksidente të ndryshme, fatkeqësi natyrore, si dhe në ato të shkaktuara nga dora e njeriut.

Qëllimi i Politikës së Shërbimit: Zvogëlimi i riskut nga fatkeqësitë dhe menaxhimi i tyre, duke siguruar mbrojtjen e jetës së njerëzve, pronës, trashëgimisë kulturore dhe mjedisit, nëpërmjet sistemit të mbrojtjes civile.

- 1.Përafrimi me standartet europiane të organizimit të mbrojtjes civile.
- 2.Sigurimi i mbrojtjes civile në të gjithë territorin.
- 2.Parandalimi.
- 3.Informim publik për rreziqet dhe aktivitetet e organeve vendore përgjegjëse për mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera.
- 4.Garantimi i shërbimit të zjarrfikësve në nivel lokal dhe administrimi i strukturave përkatëse, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj;

-Objektivat e programit buxhetor për përmbushjen e këtij qëllimi për vitin 2022 janë:

- O 1. Strukturat për planifikimin, menaxhimin dhe përballimin e emergjencave civile.
- O 2. Shërbim i përmirësuar i MZSH me prioritet parandalimin e ngjarjeve.

Rezultatet e programit Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile

					000/leke
Programi	Paga +	Shpenzime	Transferta	Investime	Totali
P 03280	Sigurime	Operative			
Plani 4-mujorin e parë	7,675	3,321			10,996
Realizimi 4-mujorin e parë	4,065	538			4,603
Diferencë	3,610	2,783			6,393
Realizimi në %	53 %	16 %			42 %

Realizimi shpenzime për paga dhe sigurime është realizuar në masën 53 % sepse nga 16 punonjës që janë planifikuar janë emëruar 12 punonjës .

Shpenzimet operative janë realizuar në masën 16 %.

Realizimi total i këtij programi 42 %.

- ❖ Detajimi i shpenzimeve operative për programin “Mbrotja nga zjarri dhe mbrotja civile” 3280
Shpenzimet operative janë realizuar me 16 % kjo për shkak të disa kontratave të cilat nuk janë realizuar dhe konkretisht është :
 - Blerje goma + pjesë xhenerike, mirëmbajtje mjeteve , nuk është prokuruar.
 - Blerje materiale të # elektrike, hidraulike etj + shpenzime për mirëmbajtjen , funksionimin e pajisjeve të zyrës dhe pajisjeve speciale , nuk prokuruar.
 - Blerje rroba pune për punonjësit është refuzuar malli pasi nuk përmbushte specifikat e përcaktuara.
 - Blerje rafte për garderopen është prokuruar në shkurt të 2022 dhe është likuiduar në maj.

Nr.	Emertimi i shpenzimeve	Kap	Plani vjetor	Shtesa	Pakësime	Plani me ndryshime 2022	Fakti 2022
1	Shpenzime për energjinë	1	300			300	7
2	Shpenzime për ujësjellësin	1	100			100	12
3	Blerje tymuse për imitimit stervitje dhe mbushje të fikseve të zjarrit	1	40			40	
4	Udhëtime e dieta brenda vendit	1	500		50	450	
5	Blerje karburant	1	1,200			1,200	219
6	Blerje goma + pjesë xhenerike, mirëmbajtje mjeteve	1	500			500	
7	Blerje materiale të # elektrike, hidraulike etj + shpenzime për mirëmbajtjen , funksionimin e pajisjeve të zyrës dhe pajisjeve speciale	1	300			300	
8	Siguracion i jetës për zjarrfikësit	1	350	50		400	
9	Siguracion makinash	1	80				
	Të trashëguara nga viti 2021						
10	Blerje goma pjesë xhenerike dhe mirëmbajtje mjeteve	1	499			499	
11	Mirëmbajtje rrjeti I ndricimit +blerje materiale të ndryshme elektrike hidraulike, shpenzime për mirëmbajtjen funksionimin e pajisjeve të zyrës dhe pajisjeve speciale	1	300			300	300
12	Blerje rroba pune	1	587			587	
13	Blerje rafte për garderopen	1	250			250	
	Totali		5,006	50	50	5,006	538

Për vitin 2022 në Programin "Mbrotjtja nga zjarri dhe mbrotjtja civile" në funksion të veprimtarisë kryesore dhe përmbushjen e objektivave të përcaktuara, janë parashikuar 3 aktivitete.

-Aktivitetet janë realizuar si me poshtë:

- O1. Përballimi i ndihmave të menjëherëshme për familjet me raste fatkeqësie .
- O2. Plotësimi i dokumentacionit ligjor teknik për masat MZSH .
- O3. Shërbimi i Mbrotjtjes nga zjarri dhe shpëtimi .

Programi 10910 : Emergjenca Civile

Realizimi i qëllimit dhe objektivave të politikës së programit.

Mbrotjtja Civile synon krijimin e kushteve për një shoqëri të aftë për të zvogëluar risqet e fatkeqësive, për të parandaluar, përgatitur, përballuar fatkeqësitë dhe për t'u rimëkëmbur, nëpërmjet një sistemi të integruar dhe efikas të mbrotjtjes civile në Republikën e Shqipërisë.

Qëllimi i Mbrotjtjes Civile është zvogëlimi i riskut nga fatkeqësitë dhe realizimi i mbrotjtjes civile për të garantuar mbrotjtjen e jetës së njerëzve, të gjësë së gjallë, të pronës, të trashëgimisë kulturore e të mjedisit, nëpërmjet forcimit të sistemit të Mbrotjtjes Civile, duke përcaktuar përgjegjësitë e institucioneve dhe të strukturave të këtij sistemi, bashkëpunimin ndërkombëtar, të drejtat dhe detyrimet e shtetasve dhe të subjekteve private, edukimin, trajnimin, inspektimin.

Për shkak të karakteristikave gjeografike të Shqipërisë, fatkeqësitë natyrore, sidomos përmbytjet, zjarret, tërmetet, rrëshqitjet e tokës, si dhe bllokimet nga reshjet e borës, janë dukuri të zakonshme. Rreziku i fatkeqësive mjedisore është në rritje, për shkak të urbanizimit dhe industrializimit, megjithatë, nuk përjashtohen dhe kërcënimet bashkëkohore të terrorizmit dhe të epidemive të ndryshme.

Objektivat e programit :

O.1 Të parandalohet, të lehtësohet dhe të riaftësohet nga çdo dëmtim që prek popullatën, gjënë e gjallë, pronën, trashëgiminë kulturore dhe mjedisin nga emergjencat civile.

O.2 Të sigurohen kushtet për institucionet shtetërore, publike dhe private, për veprimtaritë ekonomike dhe për popullatën, për kalimin nga gjendja normale e jetesës dhe e punës në një situatë emergjente, me humbje sa më të vogla për ruajtjen e rendit, për jetën e njerëzve, për gjënë e gjallë, për pronën, për trashëgiminë kulturore dhe për mjedisin, ndaj efekteve të një emergjence civile.

O.3 Të garantohet përdorimi i të gjitha burimeve të mundshme të shtetit me qëllim sigurimin publik, ruajtjen e vazhdueshme të ekonomisë kombëtare, lokalizimin e zonës së emergjencës dhe lehtësimin e pasojave.

❖ **Rezultatet e programit: të “Emergjenca civile”.**

					000/leke
Programi P010910	Paga + Sigurime	Shpenzime Operative	Transferta	Investime	Totali
Plani 4-mujorin e parë		537			537
Realizimi 4- mujorin e parë		537			537
Diferencë					
Realizimi në %		100%			100%

Në buxhetin e vitit 2022 janë planifikuar 1,500 mijë lekë për Emergjenca civile. Nga sektori i Emergjencave civile janë shqyrtuar disa raste dhe janë propozuar në kshillin bashkiak konkretisht :

- V.K.B NR.10 date 28.02.022 Pastrim rrugesh nga debora Njësia Administrative Hotolisht,Qendër ,Lunik,Orenjë ,Polis në vlerën 420 mijë lekë.
- V.K.B NR.24 date 29.03.022 Pastrimrrugesh nga debora Njësia Administrative Steblevë në vlerën 117 mijë lekë.

FUNKSIONI 4: ÇËSHTJE EKONOMIKE

Nënfunkcioni 041: Çështje të përgjithshme ekonomike, tregtare dhe të punës.

Programi 04130: Mbështetja për zhvillim ekonomik

Administrimi i çështjeve dhe shërbimeve të përgjithshme ekonomike dhe tregtare; Forcimi i zhvillimit ekonomik dhe punësimit vendor.

- Hartimi, zbatimi dhe monitorimi i politikave të përgjithshme ekonomike dhe tregtare të njësisë së vetëqeverisjes vendore;
- Fondet e pushtetit qendror për funksionin e deleguar të regjistrimit dhe liçensimit të bizneseve;
- Mbajtja e kontakteve me qeverisjen qendrore dhe me biznesin për të garantuar politika zhvilluese në nivel rajonal dhe garantimin e zhvillimit ekonomik;
- Funksionimi ose mbështetja me politika vendore të zhvillimit ekonomik dhe tregtar brenda njësisë;
- Mbështetje dhe promovim i bizneseve vendore në funksion të zhvillimit ekonomik brenda territorit të njësisë vendore ;
- Organizim i shërbimeve në mbështetje të zhvillimit ekonomik vendor, si informacion mbi bizneset, aktivitetet promovuese etj.
- Publikimi i broshurave informative, krijimi i portaleve me profil ekonomik etj.
- Grante, hua ose subvencione për të promovuar politikat e përgjithshme dhe programet vendore ekonomike dhe tregtare për të nxitur punësimin;

Rritja ekonomike dhe hapja e vendeve të reja të punës në ekonomitë në zhvillim, varen nga dy faktorë kryesorë: tërheqja e investitorëve të huaj dhe zhvillimi i ndërmarrjeve të Vogla dhe të mesme. Klima e favorshme e biznesit është thelbësore për tërheqjen e investimeve të huaja dhe për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Në

këtë kuadër, politikat e zhvillimit të Bashkisë Librazhd janë fokusuar në zhvillimin e një ekonomie të gjallë për qytetin dhe zonat rurale sipas parimit të plotësueshmërisë ndërmjet qytetit dhe zonave rurale.

Qëllimi i Politikës së Shërbimit: Zhvillimi lokal i udhëhequr nga komuniteti duke nxitur kohezionin territorial përmes hartimit të planeve dhe programeve duke mbështetur dhe koordinuar strukturat e bashkisë, në realizimin e reformave për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga procesi i Integritimit European. Mbështetjen e veprimtarive prodhuese nëpërmjet promovimit të tyre dhe asistimit për përthithjen e granteve dhe ndihmave financiare.

Objektivat për përmbushjen e këtyre funksioneve për vitin 2022 janë:

O1. Mbështetja për përmirësimin e klimës për zhvillimin e biznesit nëpërmjet ngritjes së strukturave të dedikuara, bashkëpunimit me institucione të specializuara dhe aktorët e interesuar për hartimin e strategjive dhe planeve zhvillimore lokale.

O2. Promovimi i produkteve vendore dhe fuqisë së punonjësve të specializuar për tregun lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar.

O3. Hartimi dhe publikimi i materialeve informative dhe promocionale për nxitjen e investimeve vendase dhe të huaja.

O4. Nxitja dhe mbështetja e bashkëpunimit të biznesit vendor, nëpërmjet iniciativave financiare, për zhvillimin dhe fuqizimin e tyre.

Rezultatet e programit 04130: Mbështetja për zhvillim ekonomik

000/leke					
Programi	Paga +	Shpenzime			
P04130	Sigurime	Operative	Transferta	Investime	Totali
Plani 4-mujorin e parë	507	20			527
Realizimi 4-mujorin e parë	502				502
Diferencë	5				
Realizimi në %	100 %	0			95 %

O1. Monitorimi dhe Vlerësimi i strategjise se zhvillimit të Bashkisë Librazhd

Hartimi i Planit të Përgjithshëm Vendor konsiderohet si një instrument i rëndësishëm për zhvillim, i cili përfshin identifikimin dhe shfrytëzimin kryesisht të burimeve vendore, ideve dhe aftësive për të stimuluar rritjen dhe zhvillimin ekonomik. Ky proces shoqërohet me monitorimin dhe vlerësimin e tij, si mekanizëm tepër i vlefshëm për të treguar nëse burimet në dispozicion janë të mjaftueshme, janë përdorur me efektivitet dhe nëse po bëhet ajo që është planifikuar. Si rrjedhojë, Bashkia Librazhd ka përgjegjësinë e garantimit, që plani i zhvillimit ekonomik të përmbushë objektivat e deklaruara dhe me efektivitet kostoje për dy arsye kryesore, marrjen e vendimeve dhe vendosjen e përgjegjshmërisë. Qëllim është të monitorojë dhe vlerësojë Planin e Përgjithshëm Vendor, të raportojë mbi bazën e alokimit faktik të burimeve financiare dhe të matë rezultatet e arritura në raport me rezultatet e planifikuara.

O2. Krijimi i instrumentit financiar për forcimin e kapaciteteve të OSHC-ve nëpërmjet aplikimeve në bazë projekti për ofrimin e shërbimeve cilësore në komunitet (ReLoad)

Pjesëmarrja në Programet Europiane është projektuar për t'u mundësuar shteteve, njohjen me metodat dhe politikat e Bashkimit Europian (BE). Anëtarësimi në Bashkimin Europian (BE) konsiderohet si një sfidë, por gjithashtu integrimi evropian është prioriteti kryesor për Shqipërinë dhe një rol të rëndësishëm luan edhe qeverisja vendore. Shqipëria përfiton nga Programet Europiane dhe në këtë kuadër edhe njësitë e qeverisjes vendore kanë të drejtë të përfitojnë nga financimi i fondeve të BE-së. Shkalla e përfitimit të fondeve të BE-së në nivel vendor varet nga angazhimi i njësive vendore në këtë proces. Duke marrë në konsideratë rëndësinë e bashkëpunimit ndërkufitar dhe rajonal, Bashkia Librazhd shpreh angazhimin e saj për marrjen pjesë në Programet e BE-së me qëllim rritjen e shërbimeve publike për qytetarët me standarde europiane.

Ngritja dhe funksionimi i Food Hub është një zgjedhje premtuese nga e cila do të përfitojnë të gjithë qytetarët e Librazhdit duke përmirësuar aksesin në zhvillimin social-ekonomik dhe mundësitë e punësimit, shërbimet dhe lehtësitë në komunitete vulnerabël. Ky projekt do të zjasë 28 muaj dhe financimi është nga Komisioni Europian.

Objektivi specifik : *Të krijohen mundësi /modele për gjenerimin e të ardhurave ,duke kontribuar në uljen e varfërisë në kontekstin e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik rural.*

O1. Është krijuar Food Hub për grumbullimin ,ftohjen, ruajtjen, paketimin, certifikimin, marketingun dhe shitjet ;

O2. Marrëveshjet afatgjata ndërmjet fermerëve /bizneseve dhe qendrës funksionale për grumbullimin e produkteve bujqësore ,blektorale dhe mjekësore;

O3. Produktet e certifikuara janë mjaft konkurruese për të hyrë në treg dhe për të garantuar shitje më të mira;

O4. Të rinjtë kanë përmirësuar njohuritë aftësitë dhe qëndrimin për vetëpunësim ;

O3. Pjesëmarrje në programet dhe projektet e financuara nga Bashkimi Europian dhe Organizata të tjera ndëkomëtare.

Procesi i integritetit evropian është sfida dhe prioriteti kryesor për Shqipërinë, ku pa dyshim një rol të rëndësishëm në këtë proces luan edhe qeverisja vendore. Mjetet me të cilin BE mbështet Shqipërinë në rrugën e saj drejt anëtarësimit janë programet e BE-së. Në këtë kuadër njësitë e qeverisjes vendore kanë të drejtë të përfitojnë nga financimi i fondeve të BE-së. Shkalla e përfitimit të fondeve të BE-së në nivel vendor varet nga angazhimi i njësive vendore në këtë proces. Prandaj është me shumë rëndësi që qeverisja vendore të fokusojë prioritetet e saj edhe në drejtim të forcimit të bashkëpunimit rajonal dhe ndër-rajonal duke aplikuar në programe të ndryshme të BE-së. Duke marrë në konsideratë rëndësinë e bashkëpunimit ndërkufitar dhe rajonal, Bashkia Librazhd shpreh angazhimin e saj për marrjen pjesë në Programet e BE-së me qëllim rritjen e shërbimeve publike për qytetarët me standarde të përafëruara europiane.

O4. Informimi në menyre periodike për publikun dhe grupet e tjera të interesit për procesin e Integritetit Evropian

Projekti “Bashkitë për në Evropë”, i mbështetur nga Bashkimi Evropian, synon fuqizimin e pushtetit vendor në Shqipëri gjatë procesi të integrimit. Në kuadër të këtij projekti është ngritur zyra e çështjeve të BE-së pranë 61 bashkive. Kjo zyrë luan një rol të rëndësishëm në promovimin e parimeve të BE-së në nivel vendor si dhe sherben si një urë për absorbimin e fondeve/programave të BE. Ketu behet informimi në mënyrë periodike i publikut dhe i grupeve të tjera të interesit për procesin e integrimit evropian, për politikat e BE-së dhe mundësitë për përfitim nga asistenca e Bashkimit Evropian.

Në këtë kuadër zyra e çështjeve të BE-së Librazhd do të sigurojë dhënien e informacionit të nevojshëm për publikun dhe grupet e tjera të interesit për procesin e integrimit evropian, për politikat e BE-së dhe mundësitë për përfitim nga asistenca e Bashkimit Evropian. Njëkohësisht do të bëjë shpërndarjen e materialeve promovuese mbi fondet, programet dhe projektet e BE-së.

O5.Organizimi i një panairi punë dhe bizneseve në Bashkinë Librazhd

Rajoni i Librazhd, është i prekur nga një numër i lartë i të papunëve. Në Universitete si dhe në shkollat profesionale çdo vit diplomohen një numër i konsiderueshëm studentësh, të cilët kanë vështirësi të integrohen në tregun e punës. Nga ana tjetër në Bashkinë e Librazhdit operojnë një numër relativisht i mirë i aktivitetëve ekonomike të sektorëve të ndryshëm të cilët gjithashtu herë pas here kanë vështirësi në gjetjen e punonjësve e sidomos të atyre të kualifikuar. Kjo gjë ndodh nga mungesa e informacionit si për vendet e punës së disponueshme por gjithashtu edhe për mundësitë që kanë bizneset për të punësuar punonjës të kualifikuar.

O6. Panairi i produkteve agroperpunuese sipas njësive administrative

Bashkia Librazhd për shkak të pozicionimit gjeografik dhe resurseve natyrore që disponon ka potenciale të madhe për zhvillimin ekonomik. Baza ekonomike është blegtoria,dhe bujqesia sidomos në zonën malore të saj. Përveç tyre, produkte të tjera tipike të zonës janë të lidhura me vreshtarinë, dhe frutat/perimet.Në këtë kuadër me qellim zhvillimin e biznesit të vogël nëpërmjet veprimtarive nxitëse bashkia ka parashikuar organizimin e panairove te produkteve agropërpunuese. Në këtë panair prezantohen të gjitha njësitë administrative të Bashkisë Librazhd me produktet vendase, me pasuritë e tyre kulturore dhe ushqimin tradicional. Ky aktivitet *“Festa e Mjaltit”* eshte planifikuar ne muajin shtator . Kjo traditë do të vazhdojë edhe në vitet e ardhshme me më shumë prodhues .

O7. Shërbimet e deleguara të QKB

Pagesa e punonjësve të QKB pranë institucionit tonë bëhet në mbështetje të nenit 8, pika 1 dhe 2; dhe nenit 9, pika 2, të ligjit nr 131/2015 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit” .Aktualisht janë dy punonjës që ofrojnë shërbimin pranë zyrës së QKB në Bashkinë Librazhd . Përmiresimi i vazhdueshëm i shërbimit është nje nga pikat e forta te QKB dega Librazhd.

O8. Ristrukturimi dhe pasurimi i faqes Web te Bashkise

Bashkia Librazhd nëpërmjet faqes së saj të internetit ofron informacione të ndryshme për shërbime ndaj qytetarëve, bizneseve si dhe informacione të ndryshme informative statistikore dhe

social kulturore. Kjo faqe web është pasuruar dhe më tej në lidhje me rikonceptimin e strukturës së informacionit dhe shërbimeve që ofron ndaj të bërit biznes të Librazhdit . Proçesi i pasurimit të faqes web të Bashkisë Librazhd është i vazhdueshëm gjatë gjithë vitit.

O9.Publikim i katalogut te produkteve te territorit te Bashkise Librazhd

Me ndarjen e re territoriale, territori i Bashkisë Librazhd është zgjeruar, duke rritur kështu edhe gamën e produkteve që ofron zona. Duke marrë parasysh kërkesat në rritje të tregut ndërkombëtare për këto produkte dhe larminë e produkteve që ofron ky territor, lind nevoja për një ofertë produktesh cilësore dhe të garantuara për konsumatorin vendas , por edhe rritjen e imazhit të këtyre produkteve ”Made in Albania” të destinuara për tregjet rajonale e me gjerë.

Panairet e organizuara gjate vitit 2021 kane nxjerre ne dukje nevojën për promovimin e produkteve tona bujqesore, blegtorale, te artizanatit, industriale etj. Bashkia Librazhd është e pasur me shumëllojshmëri produktesh bujqesore dhe blektorale të cilat janë të pastra dhe pa kimikate dhe ne i konsiderojme vlerë të shtuar të territorit tone. Promovimi i kesaj larmie produktesh qe territori jone ofron eshte nje mundesi shume e mire per prodhuesit qe deshirojne te gjejne tregje te reja shitjeje.

Qëllimi kryesor është të krijojme mundësi ekonomike të përmirësuara, siguri dhe një klimë të mirë biznesi mes anëtarëve të rruges tregtare të përzgjedhur.

Projekti do të ketë një ndikim të rëndësishëm social-ekonomik për banorët e Librazhd duke kontribuar në përmirësimin e aksesit ndaj shërbimeve bazë dhe tregjeve.

O10. Mbështetja dhe lehtësimi i bizneseve për aplikime në programet dhe skema të ndryshme financiare.

Bizneset ekzistuese në Librazhd kanë hasur vështirësi për të aplikuar në programet dhe në skemat e ndryshme financiare qeveritare. Kjo ka ardhur si rezultat i mungesës së informacionit dhe gjithashtu vështirësive që hasin në plotësimin e dokumantacionit ligjor, sipas udhëzimeve të përcaktuara nga ministria e linjës apo edhe nga rregulloret e programeve të ndryshme. Programet mbështetëse dhe instrumentat financiare qeveritare janë një mënyrë e mirë për rritjen e konkurrencës në sektorin e bujqësisë dhe industrisë ushqimore, në rritjen e qëndrueshmërisë ekonomike të zonave malore të disavantazuara, rritjen e ekonomisë lokale nga njëra anë dhe nga ana tjetër përforsimi i marrëdhënieve ekonomike me Bashkimin Europian, mbrojtjen e mjedisit, nxitjen e transportit të qëndrueshëm dhe të infrastrukturës publike etj. Ne kete kuader bashkia Librazhd jep asistencen e saj për plotësimin e dokumentacionit për aplikim per ato subjekte qe kane nevojë.

Programi: 04240 Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit.

1. Sektori i ujitjes dhe kullimit , ka 2 punonjes .

Programi mbulon menaxhimin e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit në territorin e Bashkisë Librazhd . Përmirësimin e rrjetit kullues dhe ujitës që ndodhet në inventarin e saj dhe shfrytëzimin në funksion të përmirësimit të prodhimit bujqësor.

Ndërtim ose organizim i sistemeve të kontrollit të përmytjeve, sistemeve të ujitjes dhe kullimit, duke përfshirë grante, hua dhe financime për punime të tilla.

Administrim, shfrytëzim dhe mirëmbajtje e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit nën përgjegjësinë e njësive të vetqeverisjes vendore. Bashkia Librazhd ka ushtruar funksionin e saj në realizimin e objektivave për përmirësimin e sistemit vendor të kullimit.

Realizimi i qëllimit dhe objektivave të politikës së programit

Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Shërbimit: Administrimi, shfrytëzimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, furnizimi me ujë për vadije të fermave bujqësore.

Objektivat e programeve buxhetore për përmbushjen e këtyre qëllimeve për vitin 2022 janë:

O1. Përmirësimi i sistemit të ujitjes dhe kullimit. Ndërtim ose organizim i sistemeve të kontrollit të përmytjeve, sistemeve të ujitjes dhe kullimit.

Rezultatet e programit Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit.

000/leke					
Programi P 04240	Paga + Sigurime	Shpenzime Operative	Transferta	Investime	Totali
Plani 4-mujorin e parë	955	300		6,140	7,395
Realizimi 4- mujorin e parë	345			5,406	5,751
Diferencë	610	300		734	1,644
Realizimi në %	36 %	0		88 %	78 %



Shpenzime për paga është realizuar në masën 36 % pasi një punonjës ka dalë në pension dhe ky vend është vakant .
 Shpenzime koherente janë realizuar në masën 0 %pasi për këtë program janë planifikuar vetëm blerje tuba për kanale vaditëse ,zë i cili nuk është prokuruar akoma..
 Shpenzime kapitale janë realizuar në masën 88 %.

❖ *Realizimi i investimeve për programin Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit.*

04240	Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit	38,818,376			42,767,670	17,690,270	5,405,658
1	Rikonstruksion kanali Rine Dorez Qender	15,958,376	2020	2022	15,575,610	3,575,610	3,396,731
2	Rikonstruksion ne kanale vaditese Kanali Joletes Polis ,kanali Taksimi Gjures Kuterman,kanali vija e vogel Dardhe,Vija e Gurit Prevall	9,360,000	2021	2022	9,192,060	2,114,660	2,008,927
3	Blerje tuba per kanalet vaditese	1,500,000	2022	2022	1,500,000	1,500,000	
4	Rikonstruksion i kanaleve vaditese ne Bashkine Librazhd	12,000,000	2022	2023	12,000,000	6,000,000	
5	Riparime te pjeseshme ne kanalet vaditese ne Bashkine Librazhd	4,500,000	2022	2022	4,500,000	4,500,000	

Hartimi i projekteve të ndërhyrjes për pastrim/reabilitim të Kanaleve Kullues bazuar në Planifikimin e miratuar në Planin e Veprimit për Përmirësimin e Shërbimit të Kullimit , ndërhyrje pastrimi dhe vendosje në gjëndje funksionale të K.K. të dyta dhe të treta.

Sistemi i kullimit, si pjesë e rëndësishme e programit dhe objektivave, vazhdon të jetë prioritet i Bashkisë Librazhd në fushën e bujqësisë.



Programi: 04260 Administrimi i Pyjeve dhe Kullotave. (12 punonjës)

Në këtë shërbim bashkia planifikon shpenzimet buxhetore për sigurimin e administrimit të çështjeve dhe shërbimeve pyjore, administrimin e fondit pyjor dhe kullor, shfrytëzimin e racionalizuar të rezervave pyjore dhe kullor, konservimin dhe zgjerimin e tyre. Bashkia siguron mikëqyrjen dhe disiplinimin e operacioneve pyjore, dhënien e licencave për prerje pemësh, ripyllëzime, kontrole të dëmtuesve dhe sëmundjeve si dhe ofrimin e shërbimeve për operatorët pyjorë.

- Administrimi i çështjeve dhe shërbimeve pyjore;
- Konservim, zgjerim dhe shfrytëzimi racionalizuar rezervave pyjore;
- Administrimi fondit pyjor dhe kullor publik;
- Mbikëqyrje dhe disiplinimi operacioneve pyjore dhe dhënie e licencave për prerje pemësh.
- Organizim ose mbështetje për veprimtarinë ripyllëzuese, kontrollin e dëmtuesve dhe sëmundjeve, shërbimet pyjore për luftën kundër zjarrit dhe për parandalimin e zjarrit si dhe ofrimin e shërbimeve për operatorët pyjorë;
- Prodhim dhe përhapje e informacionit të përgjithshëm, dokumentacionit teknik dhe statistikave për çështjet dhe shërbimet pyjore;
- Grante, hua ose financime për të mbështetur veprimtaritë tregtare pyjore;
- Shpërndarja e kullotave, duke përfshirë menaxhimin e kullotjes;

Qëllimi i Politikës së Shërbimit: Administrimi i pyjeve dhe kullotave vendore si dhe menaxhimi institucioneve në shërbim të këtij funksioni, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

Përshkrimi i objektivave

O1: Sigurimi i mbrojtjes për qeverisjen e qëndrueshme dhe kontrollin e mirëadministrimit të fondit pyjor dhe kullor brenda territorit administrativ të bashkisë.

O2. Hartimi / Rishikimi i Planeve të mbështetimit për të gjithë sipërfaqen e fondit pyjor dhe kullor.

O3.Rehabilitimi dhe pyllëzimi i sipërfaqeve pyjore/kullorë ,të degraduara, djegura si edhe mbrojtja e tokës nga erozioni (Projektim/Investim).

❖ Rezultatet e Programit Administrimi i Pyjeve dhe Kullotave

					000/leke
Programi P 04260	Paga + Sigurime	Shpenzime Operative	Transferta	Investime	Totali
Plani 4-mujori i parë	4,517	8,905		734	14,156
Realizimi 4-mujori i parë	2,410	2			2,412
Diferencë	2,107	8,903		734	11,744
Realizimi në %	53 %	0		0	17 %

Shpenzimet për paga janë realizuar në masën 53 % nga 12 punonjës të planifikuar janë emëruar 9 punonjës.

Shpenzimet operative janë realizuar me 0 %.

❖ Detajimi i shpenzimeve operative për programin “Administrimi i Pyjeve dhe Kullotave “ 4260 .

Nr.	Emertimi i shpenzimeve	Kap	Plani vjetor	Shtesa	Pakësime	Plani me ndryshime 2022	Fakti 2022
1	Shpenzime për energjinë	1	150			150	2
2	Shpenzime për ujësjellësin	1	50			50	
3	Prodhim, prerje ,transport dhe stivosje materiale drusore për Bashkinë Librazhd	5	8,976			8,976	
4	Blerje karburant	1	430			430	
5	Blerje shtypshkrime	1	625			625	
6	Blerje mjete pune	5	150			150	
7	Blerje goma + pjesë xhenerike,mirëmbajtje mjetesht	5	300			300	
8	Shpenzime per blerje tabela informuese per zjarret,kafshe te egra,prerje ilegale etj	5	150			150	
9	Pastrim pyjesh Ah	5	1,207		1,207	-	
	Trashëguara nga vitit 2021						
10	Prodhim prerje transport dhe stivosje materiale drusore per bashkine Librazhd per ekonomine pyjore Polis dhe Dardhe -Xhyre ,Loti I	5	4,305			4,305	
11	Prodhim prerje transport dhe stivosje materiale drusore per bashkine Librazhd per ekonomine pyjore Klenje ,Cermenik dhe Neshte - Prevalle Loti II	5	3,635			3,635	
	Totali		19,978		1,207	18,771	2

❖ Realizimi i investimeve për programin Administrimi i Pyjeve dhe Kullotave.

04260	Administrimi i Pyjeve dhe Kullotave	2,645,800			2,645,800	2,645,800	0	
1	Pyllezime ne pyjet e Bashkise Librazhd	1,200,000	2022	2022	1,200,000	1,200,000		Pa prokuruar
2	Pyllezim ekonomia pyjore Neshte Prevalle	1,207,000	2022	2022	1,207,000	1,207,000		Pa prokuruar
3	Blerje makineri per prerje carje dru zjarri	238,800	2021	2021	238,800	238,800		Pa prokuruar

Objektivat e Programit.

Për vitin 2002 në “Programin e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave” në funksion të veprimtarisë kryesore dhe përmbushjen e objektivave të përcaktuara, janë parashikuar produktet si më poshtë:

O1. Administrimi i shërbimit të pyjeve dhe kullotave në Bashkinë Librazhd .

Administrimi i fondit pyjor dhe kullësor në territorin e Bashkisë Librazhd , është një funksion i deleguar i bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 22 pika 4 dhe neni 27 pika 5.

Në përmbushje të detyrimit ligjor Bashkia Librazhd gjatë vitit 2022 punon për konsolidimin e shërbimit të Administrimit të pyjeve /kullotave nëpërmjet formimit të strukturës për administrim dhe menaxhim të këtij fondi pyjor.

O2.Mbrojtja e sipërfaqeve pyjore /kullësore/shërbimi pyjor.

Realizimi i mbrojtjes së sipërfaqeve pyjore/kullësore nëpërmjet një qeverisje të mirë të fondit pyjor/kullësor, për këtë gjatë vitit 2022 janë parashikuar për tu realizuar Kontratat e Punës për 20 Vrojtues të cilët mbulojnë Ekonomitë Pyjore .

O3.Përgatitje e materialeve për Realizimin e regjistrimit dhe inventarizimit të Pyjeve dhe kullotave bashkiake.

Jane rishikuar kufijte e zonave pyjore të të gjitha Ekonomive Pyjore e Kullësore.

O4. Pastrimi/permiresimi i parcelave pyjore.

Me ane të permiresimit (Rrallime+ Krasitje, pastrim shkurre) arrihet ruajtja e objekteve të veshura me peme nga renia e zjarreve në pyje, ruajtja e filizerisë së re , si edhe përmirësimi i pyjeve në përgjithësi.

O5.Sinjalistike pyjore në zonat pyjore të NJA .

Janë realizuar specifikimet për realizimin e tabelave për sinjalistikën ku përfshihen tabela për mbrojtjen e pyjeve nga zjarri, llojin e pyjeve, ndalimin e prerjes së pyjeve etj. Aktualisht është realizuar shërbimi.

Nënfunksi 045: Transporti

Programi 04520: Rrjeti rrugor rural

Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e rrugëve vendore dhe sinjalizimit rrugor brenda juridiksionit të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

- Ndërtimi dhe mirëmbajtja e sistemeve rrugore dhe strukturave të transportit (rrugë, ura, tunele, parkime, terminale autobusësh, rrugë këmbësore dhe korsi biçikletash etj.) dhe sinjalizimi rrugor trotuareve dhe shesheve publike vendore nën administrimin dhe përgjegjësi të njësisë së vetëqeverisjes vendore;
- Studime për rehabilitimin, përmirësimin, ndërtime të reja në sistemet e transportit për rrjetin rrugor nën administrimin e njësisë vendore;
- Marrja e masave për lehtësimin e trafikut dhe kontrollin e sistemit rrugor rural të njësisë vendore;

Përmirësimi dhe modernizimi i infrastrukturës rrugore urbane dhe infrastrukturës rrugore rurale duke mundësuar akses të plotë të tyre në sistemin e infrastrukturës rrugore kombëtare dhe ndërkombëtare.

Qëllimi i Politikës së Shërbimit: Përmirësimi dhe modernizimi i infrastrukturës rrugore urbane dhe infrastrukturës rrugore rurale duke mundësuar akses të plotë të tyre në sistemin e infrastrukturës rrugore kombëtare dhe ndërkombëtare. Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e rrugëve vendore, trotuareve dhe shesheve publike vendore; Përmirësimi i rrjetit të rrugëve rurale duke siguruar lidhjen e të gjitha qendrave të banuara me rrjetin rrugor urban dhe kombëtar. Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e rrugëve vendore, trotuareve dhe shesheve publike vendore;

Objektivat për secilin funksion janë:

O1. Mirembajtja e rrugëve dhe shesheve urbane .

O2. Rikonstrukcion rruge dhe sheshe urbane.

O3. Përmirësimi i rrjetit të rrugëve rurale duke siguruar lidhjen e të gjitha qendrave të banuara me rrjetin rrugor urban dhe kombëtar.

O4. Hartimi i projekteve sipas prioriteteve të përcaktuara në planet e investimeve kapitale të Bashkisë Librazhd .

Rezultatet e programit 04520: Rrjeti rrugor rural

					000/leke
Programi P 04520	Paga + Sigurime	Shpenzime Operative	Transferta	Investime	Totali
Plani 4-mujori parë	19,072	11,940		54,474	85,486
Realizimi 4- mujori parë	9,054	1,571		14,400	25,025
Diferencë	10,018	10,369		40,074	60,461
Realizimi në %	47 %	8 %		26 %	29 %

Shpenzimet për paga janë realizuar në masën 47 %.

Shpenzimet operative janë realizuar me 8 %.

Investimet janë realizuar me 26 % .

❖ Detajimi i shpenzimeve operative për programin “rrjeti rrugor rural “ 4520 .

Shpenzimet operative janë realizuar me 8 % kjo për shkak se:

- Blerje goma + pjesë xhenerike, mirëmbajtje mjeteve ,nuk është prokuruar.
- Blerje materiale për mirembajtje rrugëve rurale, gabiona teli ,tombino betoni etj, nuk është prokuruar.
- Vijeime sinjalistike horizontale të rrugëve të brendshme kryesore pas asfaltimit në qytetin Librazhd kontratë e cila përfundon në 11 maj 2022 dhe nuk është prerë asnjë faturë nga operatori fitues.
- Blerje materialeve për riparim të dysheveve të urave, kontratë e lidhur në dhjetor (nuk është prerë faturë .

Nr.	Emertimi i shpenzimeve	Kap	Plani vjetor	Shtesa	Pakësime	Plani me ndryshime 2022	Fakti 2022
1	Shpenzime për energjinë	1	120			120	4
2	Shpenzime për ujësjellësin	1	50			50	3
3	Siguracion makinash	1	254			254	-

4	Blerje karburant	1	6,300			6,300	219
5	Blerje goma + pjesë xhenerike,mirëmbajtje mjetesh	1	1,500			1,500	-
6	Transport i mjeteve të rënda	5	120			120	-
7	Taksa e mjeteve	1	587			587	121
8	Blerje materiale per mirembajtje rrugeve rurale,gabiona teli ,tombino betoni etj	5	4,000			4,000	-
	Të trashëguara nga viti 2021						
9	Vijeze sinjalistike horizontale te rrugeve te brendeshme kryesore pas asfaltimit ne qytetin Librazhd.	1	597			597	-
10	Vijeze sinjalistike horizontale te rrugeve te brendeshme kryesore pas asfaltimit ne qytetin Librazhd.	5	2,381			2,381	-
11	Blerje karburant	1	1,029			1,029	1,029
12	Blerje goma pjese xhenerike dhe mirembajtje mjetesh	1	937			937	-
13	Transport I mjeteve te renda	5	195			195	195
14	Blerje rroba pune	1	50			50	-
15	Blerje materialesh per riparim te dysHEMEVE te urave	1	958			958	-
	TOTALI I SHPENZIMEVE		19,078			19,078	1,571

❖ Realizimi i investimeve për programin Rrugët Rurale.

04520	Rrjeti rrugor rural	186,479,784			185,955,617	116,388,786	14,399,688	
1	Ndertim Central Park (Parku Qendror)	43,595,531	2021	2022	43,445,026	43,445,026		Prokuruar
2	Rehabilitim per sheshet prane ujesjelles -Kanalizime,shkalleve perballe tregut	1,077,620	2022	2022	1,077,620	1,077,620		Pa prokuruar
3	Rikonstruksion i rrugeve rurale dhe veprave te artit te Bashkise Librazhd	9,987,415	2021	2022	9,933,109	4,945,694	4,698,409	Perfunduar ,likujduar
4	Rehabilitim i shesheve ne qender te fshatit Toge Nj.Adm.Qender,fshati Floq Nj.Adm Orenje	9,999,558	2021	2022	9,699,402	4,742,257	4,500,486	Perfunduar ,likujduar
5	Blerje materiale ,shtrim i rrugeve rurale me inerte	712,800	2021	2022	693,600	300,156	300,150	Perfunduar ,likujduar.
6	Instalim kamera sigurie ne rruget kryesore te qytetit (faza e dyte)	15,000,000	2022	2023	15,000,000	5,000,000		Pa prokuruar
7	Shpronesime	3,000,000	2022	2022	3,000,000	3,000,000		
8	Rehabilitim i shesheve midis pallateve lagjia Sheja	7,905,116	2022	2022	7,905,116	7,905,116		Pa prokuruar
9	Rehabilitim i sheshit Mirak Planet NJ.Adm. Polis dhe fshati Lunik.	7,848,864	2022	2023	7,848,864	5,000,000		Pa prokuruar

10	Mbrojtja lumore pergjate lumit Shkumbin	2,160,000	2022	2022	2,160,000	2,160,000		Pa prokuruar
11	Riparime te shtresave asfaltike ne Nj.Adm. dhe Bashkine Librazhd	5,000,000	2022	2022	5,000,000	5,000,000		Pa prokuruar
12	Ndertim parku i qytetit Faza III	4,000,000	2022	2022	4,000,000	4,000,000		Pa prokuruar
13	Rikonstruksion i rrugeve rurale dhe veprave te artit te Bashkise Librazhd	10,000,000	2022	2023	10,000,000	5,000,000		Pa prokuruar
14	Sitemim asfaltim i Rruges se fshatit Çerçan Nj.Adm Hotolisht	51,379,963	2022	2024	51,379,963	10,000,000		Pa prokuruar
15	Blerje fadrome per Drejtorine e Mirmbajtjes se rrugeve rurale .	3,000,000	2022	2022	3,000,000	3,000,000		Pa prokuruar
16	Rikonstruksion I rrugeve rurale per vitin 2021 Bashkia Librazhd	8,812,917	2022	2022	8,812,917	8,812,917	4,900,643	Prokuruar, proces likuidimi
17	Shpronesime	3,000,000	2,021	2,021	3,000,000	3,000,000		

Nënfunksioni 062: Zhvillimi i komunitetit

Programi 06260: Shërbimet publike

Veprimtari për zhvillimin dhe përmirësimin e jetesës.

- Planifikim i përmirësimit dhe zhvillimit të strukturave si: rekreacioni, hapësirat e përbashkëta dhe relaksuese për komunitetin;
- Mbjellja e luleve, shkurreve dhe pemëve dekorative, të cilat përmirësojnë hapsirën e gjelbërt të njësive të vetëqeverisjes vendore;
- Zëvendësimi i trotuareve të prishura me material cilësorë që përmirëson hapsirën publike dhe rrit cilësinë e shërbimit ndaj qytetarëve.
- Ndërtim, rehabilitim dhe mirëmbajtje e varrezave publike, si dhe garantimi i shërbimit publik të varrimit;
- Parqet, lulishtet dhe hapësirat e gjelbra publike.
- Të gjitha shërbimet e tjera publike sipas specifikimeve të çdo njësie të vetëqeverisjes vendore;
- Përmirësimi i cilësisë së shërbimit, menaxhimi i mbetjeve të ngurta duke filluar ndarjen në burim të atyre të riciklueshme nëpërmjet ndërgjegjësimit dhe edukimit mjedisor që bën të mundur përmirësimin e situatës mjedisore dhe reduktimin e sasisë së mbetjeve që depozitohet në landfill.

Qëllimi i Politikës së Shërbimit:

I.Garantimi për të gjithë qytetarët e saj shërbime publike cilësore në të gjithë territorin e saj pamvarësisht vendodhjes së tyre.

II.Përmirësimi i efikencës dhe efektivitetit të shërbimeve publike, modernizimi i tyre nëpërmjet përmirësimit të vazhdueshëm të teknologjisë.

III.Rritja e transparencës në lidhje me ofrimin e shërbimeve publike, dhe të sigurojë pjesëmarrjen e publikut në procesin e planifikimit dhe ta orientojë atë sipas nevojave të qytetarëve.

IV.Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e varrezave publike si dhe garantimi i shërbimit të varrimit;

-Objektivat e programit buxhetor për përmbushjen e këtyre qëllimeve janë :

O1. Përmbushja e nevojës për kryerjen e shërbimeve ditore të ruajtjes, pastrimit, mirëmbajtjes dhe të tjera për objektet dhe hapësirat publike.

O2. Shërbim cilësor me standarte dhe sipas normativave të rregullores së Mirëmbajtjes së Varrezave. Zgjerim i territorit të Varrezave për vazhdimësinë e këtij shërbimi

O3. Shtimi i aktiviteteve festive që kanë nevojë për dekorim, duke ruajtur traditën dhe kulturën tonë.

O4. Përmirësimi i cilësisë së mirëmbajtjes dhe riorganizimi i lulishteve, zgjerimi i sipërfaqeve të gjelbërta dhe gjelbërimit rrugor, në të gjithë Bashkinë.

O5. Rritja e mbulimit me shërbim.

O6. Përmirësimi i administrimit të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve urbane:

- Mbulimi i kostos nga tarifa e shërbimit.
- Norma e mbledhjes së tarifës së shërbimit.

O7. Rritja e frekuencës së mbledhjes së mbetjeve bashkiake.

Shërbimi i pastrimit

Shërbimi do të realizohet në :

- “Shërbimi i Pastrimit Zona 1(Qyteti)
- “Shërbimi i Pastrimit Zona 2 (Zona perreth qytetit)
- “Shërbimi i Pastrimit Zona 3 (Zona e Mrojtur)
- “Shërbimi i Pastrimit Zona 4 (Njesia Qender)
- “Shërbimi i Pastrimit Zona 5 (Njesia Hotolisht)
- “Shërbimi i Pastrimit Zona 6 (Njesia Polis)
- “Shërbimi i Pastrimit Zona 7 (Njesia Orenje)
- “Shërbimi i Pastrimit Zona 8 (Njesia Lunik)
- “Shërbimi i Pastrimit Zona 9 (Njesia Stebleve)
- Kontenier rezerve

Shërbimi që do të bëhet konkretisht është :

- Mbledhje largim mbetjesh
- Dezinfektim larje kontenieresh
- Fshirje rrugësh
- Larie rrugësh

Shërbimi është realizuar gjatë gjithë kohës pa ndërprerje në të gjithë territorin e bashkisë .

Rezultatet e programit 06260: Shërbimet Publike

000/leke

Programi P 06260	Paga + Sigurime	Shpenzime Operative	Transferta	Investime	Totali
Plani 4-mujorin e parë	7,716	19,069		3,000	29,785
Realizimi 4-mujorin e parë	6,112	7,340			13,452
Diferencë	1,604	11,729		3,000	16,333
Realizimi në %	79 %	38 %		0	45 %

Realizimi i shpenzimeve për paga dhe sigurime është realizuar me 79 %.

Shpenzimet operative janë realizuar me 38% .

Investime janë realizuar me 0%.

❖ Detajimi i shpenzimeve operative për programin “Shërbimet Publike ” 6260

Nr.	Emertimi i shpenzimeve	Kap	Plani vjetor	Shtesa	Pakësime	Plani me ndryshime 2022	Fakti 2022
1	Shpenzime për energjinë	1	130			130	44
2	Shpenzime për ujësjellësin	1	200			200	23
3	Siguracion makinash	1	61			61	
4	Blerje Farë bari e lule	1	400			400	
5	Blerje Karburant	1	250			250	
6	Blerje goma + pjesë xhenerike,mirëmbajtje mjeteesh	1	200			200	
7	Blerje makineri e vegla pune	1	650			650	
8	Blerje pemë dekorative	1	600			600	
9	Blerje pleh organik e kimik ,pleh për fushën e sportit	1	599			599	
10	Blerje materiale për prodhim dhe mirëmbajtje stola të lulishteve	1	200			200	
11	Vijëzime rrugore ,tabela qarkullimi,tabela emërtim rrugësh +montim	1	400			400	
12	Dekori i qytetit Viti i Ri (F.V)	1	2,000			2,000	
13	Mirëmbajtje rrjeti i ndriçimit	1	960			960	
14	Blerje materiale të # elektrike, hidraulike etj + shpenzime për mirëmbajtjen , funksionimin e paisjeve të zyrës dhe paisjeve speciale	1	700			700	

15	Shpenzime për mirëmbajtje të trotuareve , rrugëve të qytetit ,rrjete etj	1	800			800	
16	Taksa e mjeteve	1	40			40	
17	Blerje pesticide per dezinfektim,dezinsektim,Deratizim e institucioneve te Bashkise dhe institucioneve arsimore	1	400			400	
18	Shpenzime mirembajtje varrezash	1	200			200	
19	Blerje kosha te vegjel per mbeturina (ambjente te jashtme)	1	500			500	
20	Blerje materiale per riparim te ambienteve sportive ,parku I qytetit	1	300			300	
21	Blerje mallra sherbyese per armen neoparalizuese	1	563			563	
22	Blerje materiale të ndryshme për lyerje e sherbetime të objekteve arsimore në Bashki + Njësi Administrative për vitin shkollor 2021-2022	5	3,000			3,000	
23	Blerje materiale per ndertim sere	1	200			200	
	Të trashëguara nga viti 2021						
24	Dekori I Qytetit	1	678			678	678
25	Mirembajtje rrjeti I ndricimit +blerje materiale te ndryshme elektrike hidraulike,shpenzime per mirembajtjen funksionimin e paisjeve te zyres dhe paisjeve speciale	1	101			101	96
26	Blerje goma pjese xhenerike dhe mirembajtje mjetesh	1	199			199	
27	Blerje rroba pune	1	100			100	
	TOTALI I SHPENZIMEVE		14,431			14,431	840

❖ Shërbimi i pastrimit

Nr.	Emertimi i shpenzimeve	Kap	Plani vjetor	Shtesa	Pakësime	Plani me ndryshime 2022	Fakti 2022
1	Shërbimi i pastrimit dhe menaxhimit të mbetjeve për vitin 2022 Janar- Dhjetor	5	32,397			32,397	4,197
	Të trashëguara nga viti 2021						
3	Shërbimi i pastrimit dhe menaxhimit të mbetjeve Dhjetor 2021	5	3,932			3,932	2,302
	TOTALI I SHPENZIMEVE		36,329			36,329	6,499

❖ Realizimi i investimeve për programin Shërbimet Publike.

KODI	Emertimi	Vlera e plotë	Viti i fillimit	Viti i përfundimit	Plani i buxhetit viti 2022	Realizimi për periudhën e raportimit Janar-Prill 2022	Komente
06260	Sherbimet Publike	3,000,000			3,000,000	0	
1	Blerje auto vinç me kosh per Drejtorine e Puneve Publike.	3,000,000	2022	2022	3,000,000		Pa prokuruar

Nënfunksioni 063: Furnizimi me ujë

Programi 06330: Furnizimi me ujë

Sigurimi i ujit të pijshëm për banorët dhe bizneset brenda territorit të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

- Administrim i problemeve të furnizimit me ujë;
- Mbikëqyrje dhe disiplinim i të gjitha problemeve të furnizimit me ujë, duke përfshirë pastërtinë e ujit, çmimin dhe kontrollin e sasisë;
- Ngritja ose vënia në funksionim e kapaciteteve të zgjeruara në shërbimin lokal të furnizimit me ujë;
- Prodhim dhe shpërndarje e informacionit publik, dokumentacionit teknik dhe statistikave për çështjet dhe shërbimet e furnizimit me ujë;
- Grante, hua ose financime për të mbështetur ndërtimin, mirëmbajtjen ose përmirësimin e sistemeve të furnizimit me ujë

Objektivi i Politikës së Shërbimit:

I.Garantimin e shërbimeve publike cilësore për përmirësimin jetesës së qytetarëve.

II.Rritja e efikasitetit dhe efektivitetit të shërbimeve publike, nëpërmjet përmirësimit të vazhdueshëm të teknologjisë së zgjerimit të zonës së shërbimit.

III.Rritja e transparencës në lidhje me ofrimin e shërbimeve publike, duke siguruar pjesëmarrjen e publikut në procesin e planifikimit dhe të monitorimit për ta orientuar atë sipas nevojave të tyre .

IV. Prodhim, trajtim, transmetim dhe furnizim me ujë të pijshëm;

Objektivat për këtë program :

O1. Furnizimi me ujë të pijshëm i qytetit dhe njësive administrative të Bashkisë Librazhd.

O2. Mirë administrimi i shërbimit të furnizimit me ujë.

❖ Rezultatet e programit Furnizimi me ujë

					000/leke
Programi	Paga +	Shpenzime	Transferta	Investime	Totali
P06330	Sigurime	Operative			
Plani 4-mujorin e parë				3,913	3,913
Realizimi 4-mujorin e parë					
Diferencë				3,913	3,913
Realizimi në %				0	0

❖ Realizimi i investimeve për programin Furnizimi me ujë .

	Vlera e plotë	Viti i fillimit	Viti i përfundimit	Plani i buxhetit viti 2022	Realizimi për periudhën e raportimit Janar-Prill 2022	Komente
Furnizimi me ujë						
Disiplinim i ujrave të bardha në pjesën veriore të bibliotekës Librazhd	4,004,012					Prokuruar, pa likujduar

FUNKSIONI8: ARGËTIMI, KULTURA DHE FEJA

Nënfunkcioni 081: Shërbime rekreative dhe sportive

Programi 08130: Sport dhe argëtim

Ky program përfshin :

1- Klubi i Futbollit Sopoti

Programi mbulon operimin ose mbështetjen e strukturave për aktivitete çlodhëse dhe sportive dhe kontribut financiar për promovimin e sporteve.

- Vënie në funksionim ose mbështetje e strukturave për veprimtari ose ngjarje sportive aktive;
- Mbështetje për ekipet përfaqësuese vendore në veprimtaritë sportive.
- Vënie në funksionim ose mbështetje e strukturave për veprimtari ose ngjarje sportive pasive (struktura për qëndrimin e spektatorëve;).
- Grante, hua ose financime për të mbështetur ekipe ose konkurrenca apo lojtarë individualë.

Qëllimi i Politikës së Shërbimit: Krijimi i infrastrukturës mbështetëse dhe bazës materiale për zhvillimin e proceseve stërvitore për të gjitha ekipet zinxhir të klubit shumësportësh “Sopoti”. Rritja e pjesëmarrjes së të rinjve në aktivitete sportive dhe zhvillimin e sportit në komunitet.

Programi P 08130	Paga + Sigurime	Shpenzime Operative	Transferime	Totali
Plani 4-mujorin e parë			4,000	4,000
Realizimi 4-mujorin e parë			4,000	4,000

Nënfunkcioni 082: Shërbimet kulturore.

Programi 08220: Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore

Organizim, mbështetje e ngjarjeve kulturore në njësinë e vetëqeverisjes vendore; mbrojtje dhe promovim i

vlerave të trashëgimisë kulturore.

- Zhvillim, mbrojtje dhe promovim i vlerave të trashëgimisë kulturore me interes vendor, si dhe administrim i objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve;
- Mbështetja e vendeve historike, kopshteve zoologjike dhe botanike;
- Zhvillim, mbrojtje dhe promovim i bibliotekave, e ambjenteve për lexim me qëllim edukimin e përgjithshëm qytetar;
- Organizim ose mbështetje për ngjarjet kulturore (koncerte, prodhime skenike dhe filma, shfaqje artistike etj.);
- Sigurim i shërbimeve kulturore; administrim i çështjeve kulturore; mbikqyrje dhe rregullim i strukturave kulturore;
- Organizim i aktiviteteve kulturore dhe promovim i identitetit kombëtar e lokal.

Realizimi i qëllimit dhe objektivave të politikës së programit:

Qëllimi i Politikës së Shërbimit: Menaxhimi dhe administrimi i institucioneve kulturoro- artistike, aseteve të trashëgimisë kulturore, duke risjellur në vëmendjen e vizitorëve vlerat dhe pasuritë që disponohen, ndër më të pasurat në vendin tonë si në sektorin arkeologjik, etnografik, historik, të fotografisë, muzikës, teatrit etj.

Ruajtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore të zonave të ndryshme të territorit të Bashkisë së Librazhdit. Zbulimi dhe zhvillimi i talentëve në fushën e artit, sportit, si dhe edukimi dhe përçimi i vlerave kulturore dhe sportive do të jetë një nga politikat e programit. Zhvillimi, mbrojtja dhe promovimi i vlerave dhe trashëgimisë kulturore me interes lokal si dhe administrimi i objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve. Organizimi i aktiviteteve kulturore dhe promovimi i identitetit kombëtar dhe lokal si dhe administrimi i objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve.

Objektivat për këtë program :

O1: Ruajtja dhe promovimi i vlerave të trashëgimisë kulturore dhe mirëadministrimi e fuqizimi i institucioneve menaxhuese.

O2: Ruajtja, mirëadministrimi dhe pasurimi i fondit të bibliotekës .

O3: Jetë kulturore të gjallëruar nëpërmjet zhvillimit të aktiviteteve artistike dhe kulturore përgjatë gjithë vitit.

❖ Rezultatet e programit Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore :

					000/leke
Programi	Paga +	Shpenzime			
P 08220	Sigurime	Operative	Transferta	Investime	Totali
Plani 4-mujorin e parë	4,435	2,353		90	6,878
Realizimi 4-mujorin e parë	1,411	632		90	2,133
Diferencë	3,024	1,721			4,745
Realizimi në %	32 %	26.8%		100	31 %

Shpenzime për paga dhe sigurime janë realizuar me 32 %.

Shpenzime operative janë realizuar me 26.8%.

❖ Detajimi i shpenzimeve operative për programin “Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore ”
8220

Nr.	Emertimi i shpenzimeve	Kap	Plani vjetor	Shtesa	Pakësime	Plani me ndryshime 2022	Fakti 2022
1	Shpenzime për energjinë	1	300			300	62
2	Shpenzime për ujësjellësin	1	50			50	10
3	Blerje materiale higjeno sanitare	1	80			80	-
4	Shpenzime për aktivitete	1	2,000			2,000	-
5	Dieta + transport amatorësh + shpërbllim amatorësh	1	1,000			1,000	238
6	Blerje materiale të # elektrike, hidraulike etj + shpenzime për mirëmbajtjen , funksionimin e paisjeve të zyrës dhe paisjeve speciale		50			50	-
7	Blerje lule + kurora natyrore	1	300			300	228
8	Blerje libra	1	320			320	-
	Të trashëguara nga viti 2021						
9	Shpenzime per aktivitete	1	64			64	55
10	Blerje libra	1	286			286	-
11	Blerje raftesh per biblioteken	1	200			200	-
12	Mirembajtje rrjeti I ndricimit +blerje materiale te ndryshme elektrike hidraulike,shpenzime per mirembajtjen funksionimin e paisjeve te zyres dhe paisjeve speciale	1	38			38	38
	TOTALI		4,688			4,688	632

Siç shihet edhe më lart shpenzimet operative janë likuiduar 67% për shkak të :

- Blerje libra është likuiduar në maj .
- Blerje raftesh për bibliotekën është prokuruar në shkurt 2022 dhe likuiduar në maj .

FUNKSIONI 9: ARSIMI

Nënfunkcioni 091: Arsimi bazë dhe parashkollor

Programi 09120 : Arsimi bazë perfshirë arsimin parashkollor.

Programi mbulon arsimin bazë dhe parashkollor, duke bërë të disponueshme dhe duke mirëmbajtur klasat shkollore dhe duke paguar rrogat për mësuesit parashkollorë.

- Shpenzime për paga për mësuesit e kopshteve të fëmijëve dhe stafit mbështetës.
- Programe mësimore për trajtimin e edukatorëve dhe mësuesve.
- Furnizim dhe mbështetje me ushqim e kopshteve.
- Ndërtim dhe mirëmbajtje e strukturave shkollore.

Realizimi i qellimit dhe objektivave të politikës së programit:

Qëllimi i Politikës së Shërbimit: Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar.

Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar;

Objektivat e programit buxhetor:

O 1 . Sigurimi i mjediseve dhe objekteve cilësore për zhvillimin e procesit mësimor në sistemin parauniversitar dhe parashkollor.

O 2 . Krijimi i ambjenteve dhe mjediseve të sistemit arsimor bazë dhe parashkollor, të sigurtë konform standardeve ligjore.

O 3 . Organizimi i aktiviteteve dhe promovimi i identitetit kombëtar e lokal, si dhe administrimi i objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre aktiviteteve.

❖ Rezultatet e programit Drejtoria e Arsimit baze dhe parashkollor:

					000/leke
Programi	Paga +	Shpenzime	Transferta	Investime	Totali
P 09120	Sigurime	Operative			
Plani 4-mujorin e parë	38,740	12,973		12,008	63,721
Realizimi 4-mujorin e parë	25,991	4,712			30,703
Diferencë	12,749	8,261		12,008	33,018
Realizimi në %	67 %	36 %		0	48 %

Realizimi i treguesve është si me poshte:

1. Paga dhe Sigurime Shoqërore është realizuar në masën 67 %.
2. Shpenzime Operative është realizuar në masën 36 %.

❖ Detajimi i shpenzimeve operative për programin “Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor.”
9120

Shpenzimet operative janë realizuar me 36 % kjo për shkak të disa kontratave të cilat nuk janë realizuar dhe konkretisht është :

- Furnizim me ushqime per kopshte dhe cerdhe, Furnizim me mish per kopshte dhe cerdhe trashëguar nga viti 2021 ,kontratat janë përfunduar por nuk është përdorur i gjithë fondi konkretisht 1,342,165 lekë kursim nga ushqimet dhe 686,592 lekë nga kontrata e mishit .
- Furnizim me ushqime per kopshte dhe cerdhe, Furnizim me mish per kopshte dhe cerdhe për vitin 2022 nuk është prokuruar.
- Blerje materiale higjeno sanitare nuk është prokuruar.
- Blerje gaz për gatim kopshte, cerdhe nuk është prokuruar.

Nr.	Emertimi i shpenzimeve	Kap	Plani vjetor	Shtesa	Pakësime	Plani me ndryshime 2022	Fakti 2022
1	Shpenzime për energjinë + lidhje të reja	5	3,200			3,200	845
2	Shpenzime për ujësjellësin	5	1,400			1,400	438
3	Furnizim me ushqime për vitin 2022	1	6,000			6,000	-
4	Furnizim me mish për vitin 2022	1	2,480			2,480	-
5	Furnizimi me buke për vitin 2022	1	546			546	-
6	Qera për ambiente shkollore	1	2,145			2,145	475
7	Blerje materiale higjeno sanitare	1	1,530			1,530	-
8	Pakot e Vitit të Ri për kopshte, cerdhe Bashki dhe Njesi Administrative etj.	1	800			800	-
9	Blerje stufa zjarri	1	375			375	-
10	Blerje enë kuzhine kopshte e cerdhe	1	100			100	-
11	Blerje gaz për gatim kopshte, cerdhe	1	170			170	-
12	Blerje lëndë djegëse për ngrohje për shkollën e Bashkuar Hotolisht ,Shkolla9- vjecare Hotolisht Fshat	1	800			800	576
13	Blerje gaz për ngrohje për gjimnazin "I.Muça" Librazhd	1	300			300	-
	Të trashëguara nga viti 2021						-
14	Furnizim me buke kopshte cerdhe	1	31			31	31
15	Furnizim me ushqime per kopshte dhe cerdhe	1	2,519		120	2,399	1,177
16	Furnizim me mish per kopshte dhe cerdhe	1	1,126			1,126	440
17	Blerje materiale -higjeno sanitare	1	417			417	-
18	Blerje pako per vitin e ri per kopshte cerdhe	1	728			728	728
19	Blerje materiale per pastrim 22 prill Dita e Tokes	1		120		120	
	TOTALI		24,668	120	120	24,668	4,712

KODI	Emertimi	Vlera e plotë	Viti i fillimit	Viti i përfundimit	Plani i buxhetit viti 2022	Realizimi për periudhën e raportimit Janar-Prill 2022	Komente
09120	Arsimi baze perfshi arsimit parashkollor	17,703,002			17,703,002		
1	Sistem ngrohje kopshti nr.2 Bashkia Librazhd	11,265,118	2022	2022	11,265,118		Pa prokuruar
2	Hidroizolim i shkollave Dragostunje ,zdranjsh Katund, Mirake Plane Bashkia Librazhd	743,000	2022	2022	743,000		Pa prokuruar
3	Ndërtim i kështjës sportive në shkollën e mesme të bashkuar Orenje	5,694,884	2022	2022	5,694,884		Pa prokuruar

Nënfunksioni 092 : Arsimi Parauniversitar

Programi 9230 Arsimi i mesëm i përgjithshëm.

Mbështet arsimin e mesëm, duke siguruar dhe mirëmbajtur ambientet shkollore dhe pagesën e stafit mbështetës. Programe arsimore dhe trajnim për mesuesit.

- Ndërtim dhe mirëmbajtje e institucioneve shkollore;
- Ndërtim, rehabilitim dhe mirëmbajtje e ndërtesave arsimore e sistemit shkollor parauniversitar, me përjashtim të shkollave profesionale.
- Shpenzimet për paga për stafin mbështetës.
- Mbështetje për trajnimin e mësuesve.

Realizimi i qëllimit dhe objektivave të politikës së programit:

Qëllimi i Politikës së Shërbimit: Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar në arsimin e mesëm të përgjithshëm.

Objektivat e programit buxhetor:

O1. Ofrimi i shërbimeve cilësore për zhvillimin e procesit mësimor edukativ në kushte të përshtatshme në gjithë territorin administrativ të Bashkisë së Librazhdit në arsimin e mesëm .

O2. Sigurimi i mjediseve dhe objekteve cilësore për zhvillimin e procesit mësimor në arsimin e mesëm të përgjithshëm.

❖ Rezultatet e programit Arsimit të mesëm të përgjithshëm :

000/leke					
Programi	Paga +	Shpenzime	Transferta	Investime	Totali
P 09230	Sigurime	Operative			
Plani 4-mujorin e parë	1,787				1,787
Realizimi 4-mujorin e parë	845				845
Diferencë	942				942
Realizimi në %	47 %				47 %

Funksioni 10:MBROJTJA SOCIALE

Nënprogrami 101: Sëmundje dhe paaftësi

Programi 10140: Kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara

Ky program përfshin institucione dhe konkretisht:

1. Drejtorinë e Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik.

Realizimi i qëllimit dhe objektivave të politikës së programit.

Qëllimi i programit të “Kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara”.

- Krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuar, fëmijët, gratë, të moshuarit etj..., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

Objektivat e programit buxhetor:

O 1 . Partneriteti i ngushtë me shoqërinë civile, organizatat jo-fitimprurese, biznesin privat dhe biznesin social në veçanti për ofrimin e shërbimeve sociale për shtresat në nevojë.

O 2 . Krijimi i fondit të dedikuar për mbështetjen e personave me AN në bashkërendim me Shoqërinë Civile.

❖ Rezultatet e programit: “Kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara”. 000/leke

Programi	Paga + Sigurime	Shpenzime Operative	Transferta	Investime	Totali
P 010140					
Plani 4-mujorin e parë	4,273	606			4,879
Realizimi 4-mujorin e parë	2,828	146			2,974
Diferencë	1,445	460			1,905
Realizimi në %	66 %	24 %			61 %

❖ Detajimi i shpenzimeve operative për programin “Kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara.” 10140

Nr.	Emertimi i shpenzimeve	Kap	Plani vjetor	Shtesa	Pakësime	Plani me ndryshime 2022	Fakti 2022
1	Shpenzime për energjinë	1	300			300	146
2	Shpenzime për ujësjellësin	1	100			100	
3	Blerje materiale higjieno sanitare	1	86			86	
4	Blerje gaz për gatim	1	50			50	
5	Taksa e mjeteve	1	10			10	
6	Blerje karburant	1	486			486	
7	Blerje goma + pjesë xhenerike,mirëmbajtje mjeteve	1	100			100	

8	Shpenzime interneti	1	24			24	
9	Siguracion makinash	1	19			19	
10	Larje makine	1	22			22	
	Të trashëguara nga viti 2021						
11	Blerje goma pjese xhenerike dhe mirembajtje mjetesh	1	60			60	
12	Mirembajtje ambjentesh	1	24			24	
13	Qera salle per aktivitete	1	24			24	
	TOTALI		1,304			1,304	146

Në programin 10140 përfshihet Qendra Ditore e fëmijëve me aftësi të kufizuar dhe projekti “TungjatjetaJetë”, për ofrimin e shërbimeve të përkujdesjes shoqërore ,asistencë shtëpiake ,për fëmijët dhe të rinj me aftësi të kufizuar në Bashkinë Librazhd nga profesionist. Ky projekt do tu ofrojë shërbim 86 fëmijë dhe të rinj me aftësi të kufizuara në Librazhd ,do të zhvillojnë të gjithë potencialin e tyre përmes mbështetjes psiko-sociale dhe terapive,të cilat u ofrohen në qendër dhe në shtëpi nga njësia e shërbimit lëvizës. Qendra komunitare do të jetë duke ofruar shërbime të specializuara dhe mbështetëse nga punonjës social,psikologë,fizioterapist,logopedist,mësues arti ose mbështetës ,të cilat do ti referohen planit të zhvillimit të fëmijëve e të rinjve të targëtuar duke rritur kështu cilësinë e shërbimit për ta në qendër.

Objektivat e projektit janë si më poshtë:

- 86 fëmijë e të rinj me aftësi të kufizuara përfitojnë rregullisht nga shërbimi i integruar shërbime mbështetëse kognitive,psiko-sociale dhe terapeutike nga specialistët e Shërbimi Lëvizës Komunitar “Tungjatjeta ...Jetë” dhe ai i qendrës Komunitare, duke iu dhënë atyre një shanc për të realizuar potencialin e tyre të plotë.

Nënfunksioni 104: Familja dhe fëmijët

Programi 10430: Kujdesi social për familjet dhe fëmijët

Ky program përfshin institucione dhe konkretisht:

1. Sektorin e Ndihmës Ekonomike
2. Drejtorinë e Kopësht Çerdheve

Realizimi i qëllimit dhe objektivave të politikës së programit.

Qëllimi i programit të “**Kujdesi social për familjet dhe fëmijët**”.

- Mbulim sa më të plotë të territorit me Shërbime Sociale duke u harmonizuar me nevojat dhe interesat e komunitetit. Gjithëpërfshirja, pjesëmarrja, krijimi i mundësive të barabarta dhe mosdiskriminimi për shkak të aftësive ndryshe, gjinisë, origjinës, minoritetit etj. Partneriteti i ngushtë ligjor me shoqërinë civile, organizata jo-fitimprurëse, biznesin privat dhe biznesin social në veçanti.

Objektivat e programit :

O1.Mbulimi sa më i plotë i territorit, të Bashkisë, me shërbime sociale duke u harmonizuar me interesat dhe nevojat e komunitetit.

O2 Bashkërendimi dhe harmonizimi i aktiviteteve lokale me Strategjitë dhe politikat kombëtare, me institucionet në varësi të pushtetit qendror, bashkitë fqinje dhe shtetet kufitare.

O3.Partneriteti i ngushtë me shoqërinë civile, organizatat jo-fitimprurëse, biznesin privat

- dhe biznesin social në veçanti për ofrimin e shërbimeve sociale për shtresat në nevojë.
- O4. Gjithpërfshirja, pjesëmarrja, krijimi i mundësive të barabarta dhe mosdiskriminimi për shkak të aftësive ndryshe, gjinisë, moshës, origjinës, minoritetit.
- O5. Krijimi i fondit të dedikuar për mbështetjen e personave me AN në bashkërendim me Shoqërinë Civile.
- O6. Bashkërendimi dhe harmonizimi i aktiviteteve lokale me Strategjitë dhe politikat kombëtare, me institucionet në varësi të pushtetit qendror, bashkitë fqinje dhe shtetet kufitare.
- O7. Fuqizimi i Institucioneve që ofrojnë Shërbime Sociale me orientim Promovimin dhe Zhvillimin e Shërbimeve Alternative.

❖ **Rezultatet e programit: “Kujdesi social për familjet dhe fëmijët”.**

					000/leke
Programi	Paga +	Shpenzime	Transferta	Investime	Totali
P 010430	Sigurime	Operative			
Plani 4-mujorin e parë	5,426		188,081		193,507
Realizimi 4-mujorin e parë	4,404		155,808		160,212
Diferencë	1,022		32,273		33,295
Realizimi në %	81 %		83 %		83 %

O1. Zbatimi i sistemit të referimit të rasteve për viktimat e dhunës në familje. Njësitë e qeverisjes vendore, si autoritete përgjegjëse në luftën kundër dhunës në familje, kanë detyrim ligjor ngritjen dhe funksionimin e sistemit të referimit të rasteve për viktimat e dhunës në familje. (ligji nr.9669 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare, i ndryshuar me ligjin nr.47/2018 dhe VKM nr. 334, datë 17. 02. 2011 “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit tij).

O2. Dita ndërkombëtare për familjen – 15 maj

Në Ditën Ndërkombëtare të Familjes në gjithë botën organizohen aktivitete në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar, që kanë në fokus familjen, duke e përqëndruar vëmendjen tek proceset shoqërore, ekonomike dhe demografike që prekin familjet. Gjithashtu fokusi i kësaj dite është promovimi i vlerave të familjes, nxitja e barazisë midis grave dhe burrave në familje, mbrojtja e familjes si njësi bazë e shoqërisë dhe mundësia për të ndihmuar familjet për të përmbushur përgjegjësinë e tyre për komunitetin ku bëjnë pjesë.

O3. Aktivitet ndërgjegjësues në kuadër të ditës ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, 20 nëntori.

20 Nëntori “Dita Ndërkombëtare e të Drejtave të Fëmijëve” synon të promovojë mirëqenien e fëmijëve, të parandalojë çdo formë dhune apo abuzimi ndaj fëmijëve. Në kuadër të ditës ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, janë parashikuar një sërë aktiviteteve ndërgjegjëse me fëmijët dhe për fëmijët. Gjithashtu në qendrat komunitare do të organizohen takime dhe aktivitete me rastin e kësaj dite. Këto aktivitete ndërgjegjëse do të vazhdojnë të organizohen me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit mbi të drejtat e fëmijëve.

O4. Dita ndërkombëtare e fëmijëve, "1 Qeshori"

Një Qeshori është dita ndërkombëtare e fëmijëve. Këtë ditë fëmijët e të gjitha moshave kërkojnë që të jenë të lumtur e të festojnë me familjen, me prindërit, me vëmendjen dhe përkujdesjen e nevojshme për realizimin e dëshirave të tyre. Është dita kur vetë fëmijët ngrenë zërin për të drejtat e tyre, por në

ndryshim nga të rriturit, protesta e tyre bëhet me lojra festive. Kjo ditë përveç se është një ditë festive, duhet të jetë një ditë sensibilizimi për promovimin dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve. Zhvillimi i këtyre aktiviteteve kanë si qëllim të rrisin vëmendjen në drejtim të mirëqenies së fëmijëve.

O5. Dita ndërkombëtare e gruas, 8 marsi

8 Marsi njihet si "Dita e Gruas", në të gjithë botën. Në këtë ditë reflektohet mbi kurajon dhe veprimet e grave të thjeshta të cilat luajtën një rol të rëndësishëm në historinë e të drejtave të grave. Në Ditën Botërore të Gruas, në ditët e sotme, ashtu si në të shkuarën, punohet për barazinë gjinore të gruas, pavarësinë e saj, eliminimin e padrejtësive politike, për kushte më të mira pune dhe jetese. Për herë të parë 8 Marsi në Shqipëri u kremtua në vitin 1942 të shekullit të XX-të në grupe të vogla grash.

O6. Shërbime alternative për fëmijet dhe familjen.

Mbështetja dhe promovimi i të drejtave të fëmijëve për mbijetesë, mbrojtje e zhvillim; si dhe të drejtën për të jetuar e rritur në një ambient familjar. Sigurimi i mbrojtjes shoqërore për fëmijët pa kujdes prindëror dhe i të drejtave të tyre janë sfida për Bashkinë e Librazhdit, por edhe për shoqërinë civile, duke kërkuar një vëmendje më të veçantë për këtë target grup.

O7. Pagesa PAK dhe Invaliditeti

Në zbatim të Ligjin nr. 9355 datë 10.03.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore" i ndryshuar, Ligjit nr.8626 datë 22.6.2000 "Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik" të ndryshuar; Ligjit nr.8098, datë 28.03.1996 "Për statusin e të verbërit" i ndryshuar, Ligjit nr.7889 datë 14.12.1994 "Statusi i invalidit" të ndryshuar. Numri i personave të trajtuar me pagesë paaftësie ka qenë: në muajin Janar 2734 në Shkurt 2706, në Mars 2751, në Prill 2793 familje.

O8. Ndihma ekonomike

Në zbatim të Ligjin nr. 9355 datë 10.03.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore" i ndryshuar, Vendimit Nr.955 datë 07.12.2016 të Këshillit të Ministrave "Për Përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të Ndihmës Ekonomike".

Përfitues të skemës së ndihmës ekonomike kanë qenë:

Në muajin janar 2860 familje, në muajin shkurt 2760 familje, në muajin Mars 2754 familje, në muajin Prill 2760 familje.

O8. Administrimi dhe funksionimi i çerdheve.

Është realizuar vlerësimi i nevojave për ndërhyrje me qëllim krijimin e kushteve sa më të favorshme për foshnjat që frekuentojnë këtë çerdhe dhe gjithashtu familjet e tyre. Në bashkinë e Librazhdit ofrojnë shërbim për foshnjat dhe familjet e tyre 1 çerdhe. Numri i foshnjave që frekuentojnë këtë çerdhe është 85.

Nënfunkcioni 106: Strehimi Social

Programi 10661: Strehimi social

Strehim i përshtatshëm për njerëzit në nevojë, ndërtimi dhe administrimi i banesave për strehimin social.

- Ndërtim dhe administrim i banesave për strehimin social, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj;
- Administrim, organizim ose mbështetje të skemave të tilla të mbrojtjes shoqërore;
- Pagesa të kryera në mënyrë të përkohshme ose afatgjatë për të ndihmuar qiramarrësit për koston e qirasë;
- Administrim i çështjeve dhe shërbimeve të strehimit; promovim, monitorim dhe vlerësim i veprimtarive për zhvillimin e strehimit;
- Të ardhura në para për grupe të ndryshme familjarësh dhe individësh në nevojë;

- Perfitimet në para, si mbështetje për të ardhurat dhe pagesa të tjera në para për personat e varfër dhe vulnerabël me qëllim uljen e varfërisë ose për të asistuar në situata të vështira;

Realizimi i qëllimit dhe objektivave të politikës së programit.

Qëllimi i Politikës së Shërbimit: Ndërtimi dhe administrimi i banesave për strehimin social, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

Objektivat e programit :

O 1 . Përmirësimi i kushteve të banimit për shtresat në nevojë.

O 2 . Vlerësimi, planifikimi dhe sigurimi i kushteve të përshtatshme të banimit, për individët dhe familjet në nevojë, përmes ofrimit të alternativave për njëstrehim të gatshëm, të arritshëm, të përbalueshëm dhe të përshtatshëm.

❖ Rezultatet e programit: “Strehimi social”.

					000/leke
Programi	Paga +	Shpenzime	Transferta	Investime	Totali
P010661	Sigurime	Operative			
Plani 4-mujorin e parë			3,810	15,817	19,627
Realizimi 4-mujorin e parë			3,475	7,935	11,410
Diferencë			335	7,882	8,217
Realizimi në %			91 %	50 %	58 %

FAKTORËT RISK

Më poshtë po paraqesim disa nga faktorët risk që kanë ndikuar në mosrealizimin e buxhetit:

1. Mos prokurimi në kohë i procedurave të planifikuara .
2. Shtyrja e afateve të kontratave të lidhura ka sjell penges në likuidimin e tyre dhe mos realizimin e buxhetit .
3. Mos paraqitja në kohë e dokumentave (fatura,situacion) nga ana e operatorit fitues për likuidim ,konkretisht mbikqyrje –kolaudime .

Për minimizimin e këtyre faktorëve risk nevojitet marrja e masave nga :

1. Sektori juridik duhet të përshpejtojë procedurat e prokurimit sipas planifikimit në buxhet.
2. Sektori i financës do të jetë në kontakt të vazhdueshëm me operatorët fitues për sjelljen në kohë të dokumentacioneve të nevojshme për likuidim të projekteve të investuara në të kundërt do llogariten penaltete.
3. Kontakti i vazhdueshëm me operatorët ekonomikë dhe ndërgjegjësimi i tyre për prerjen në kohë të faturave .

Punoi:

P/Sektori Buxhetit
Emanuela Çekrezi

Miratoi

Dr. Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar
Aferdita Alla

DREJTORIA E TE ARDHURAVE VENDORE
MINITORIMI I TE ARDHURAVE VENDORE PER 4- MUJORIN E PARE 2022 TE
BASHKISE LIBRAZHD

Ne zbatim te Ligjit nr. 9936, date 26.06.2008 “ Per Menaxhimin e Sistemit Buxhetor ne RSH “ , Ligjit nr. 68/2017 “ Per Financat e Veteqeverisjes Vendore” ligji nr. 9632 , date 30.10.2006 “ Per Sistemin e Taksave Vendore “ Ligji 9920 date 19.05.2008 “ Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise “ , VKB, nr .95 , date 06.12.2021 “ Per Miratimin e Taksave dhe Tarifave Vendore ne Bashkine Librazhd per vitin 2022 , eshte pergatitur analiza e detajuar dhe eshte pasqyruar ne menyre te permbledhur puna e Drejtorise se te Ardhurave Vendore per 4- mujorin e pare 2022 . Zbatimi i ligjeve , vendimeve , udhezimeve , si dhe bashkepunimi me te gjitha zyrtat e tjera te administrates ka bere te mundur realizimin e te ardhurave per katernujorin e pare 2022.Gjate kesaj periudhe jane pergatitur dhe derguar zyrtarisht akt detyrimet dhe njoftim vleresimet per gjithë subjektet e biznesit madh , vogel , institucionet shteterore dhe jo shteterore , ambulante ,OJF , pronaret per ndertesat dhene ose jo me qera etj , ne rruge postare , elektronike e-maile etj, per te bere te mundur njoftimin ne kohe te gjithë subjekteve per detyrimet qe kane ndaj Bashkise Librazhd per taksa e tarifa vendore .

Duke bere krahasimet e periudhes Janar – Prill 2022 me te njejten periudhe te vitit 2021 rezulton se:

Plani vjetor 2022 eshte 153,610 mije leke, realizimi i 4- mujorit pare 2022 eshte 53,571 mije leke ose 34.9 % e buxhetit vjetor .

Plani i vitit 2021 eshte 161,133 mije leke , realizimi i 4- mujorit pare 2021 eshte 42,368 mije leke ose 26.29 % e buxhetit vjetor .

Nr	Emërtimi	Plani 4- mujori pare 2021 leke	Plani 4- mujori pare 2022 leke	Rritja per 2022 leke
1	Te ardhura te planifikuara	48,180,000	48,803,000	623,000

Periudha	Plani /000 leke	Fakti /000 leke	Diferenca /000 leke	Realizuar ne %
Plani i vitit 2022	48,803	53,571		110 %
Plani i vitit 2021	48,180	42,368	-5,796	88 %

Duke krahasuar te ardhurat e 4- mujorit pare 2022 me te ardhurat e 4- mujorit pare 2021 shihet nje rritje prej 11,203 mije leke ose 26.44 % me shume te ardhura se viti 2021 .

Tabela e realizimit te te ardhurave nga biznesi i madh , biznesi i vogel, ndertesat ,institucione shteterore , jo shteterore , legalizimet , familjare per vitet 2021, 2022 eshte si me poshte :

(Tabela nr. 1) Krahasimi i te Ardhurave te 4- mujori pare 2022 me 4- mujorin e pare 2021

/000
leke

Nr	Lloji i Takses ,Tarifes	Plani Progresiv Janar-Prill 2021	Fakti Progresiv Janar-Prill 2021	Diferenca	Plani Progresiv Janar-Prill 2022	Fakti Progresiv Janar-Prill 2022	Diferenca	Realiz.ne %2022
	<i>Te ardhura tatimore</i>							
	<i>Te ardhura nga taksat vendore</i>							
1	Tatim i thjeshtuar mbi biz e vogel	172	1255	1083	400	70	-330	
2	Taksa nga tatimi mbi te ardhurat personale	500	0	-500	1,000	0	-1000	
3	Taksa mbi ndertesat	3320	1687	-1633	3,200	1744	-1456	
4	Takse mbi truallin	148	29	-119	165	174	9	
5	Takse toke bujqesore	1558	1337	-221	1,650	1046	-604	
6	Taksa e kalim te drejtes se pronesise	164	320	156	200	56	-144	
7	Taksa e ndikimit ne infrastrukture ndertimet e reja	3280	426	-2854	3,200	1362	-1838	
8	Taksa e ndikimit ne infrastrukture nga legalizimet	1000	1187	187	1,200	836	-364	
9	Takse table	168	205	37	200	266	66	
10	Takse hoteli	48	10	-38	40	17	-23	
11	Taksa e regjistrimit pervitshem te automjeteve	2840	4167	1327	3,200	5106	1906	
12	Takse nga Renta	32	96	64	116	82	-34	
13	Takse e perkohshme e ndikimit ne infrast.ne arsim,nga 2022 taksa e perkohshe e permiresimit te infrast rrugore .	2000	847	-1153	1,630	1220	-410	
	Shuma	15230	11566	-3664	16201	11979	-4222	73.9
	<i>Te ardhura jo tatimore</i>							
	<i>Te ardhura nga tarifat vendore</i>							
1	Tarife pastrimi	5400	2348	-3052	6,000	4112	-1888	
2	Tarife ndricimi+Gjelbrimi	1128	328	-800	1,120	555	-565	
3	Tarife sherbimi ne varrezat publike	32	0	-32	32	0	-32	
4	Tarifa e sherbimit veterinar	148	0	-148	100	0	-100	
5	Tarife e tregut te organizuar	664	339	-325	480	307	-173	
6	Tarifa leje per tregetim ambulator	16	0	-16		9	-7	

					16			
7	Tarife parkimi	400	166	-234	416	204	-212	
8	Tarife per dhenie license e certifikate transporti	164	64	-100	160	548	388	
9	Tarife per leje te drejta , vertetime,informacione .	220	36	-184	232	47	-185	
10	Tarife per zenien e hapsires publike	664	3	-661	640	18	-622	
11	Tarife per librat e udhetimi te udhetareve brenda vendit	172	0	-172	120	12	-108	
12	Tarifa per autorizime ushtrim aktiviteti, autorizime per karburantet.	100	0	-100	248	4150	3902	
13	Tarifa te tjera nga Urbanistika	532	437	-95	532	164	-368	
14	Tarife per linjat ajrore dhe nentokesore	264	0	-264	130	0	-130	
15	Tarife per mbetjet inerte	64	200	136	64	33	-31	
16	Tarifa për ndikimin ne mjedis	1440	1	-1439	2,216	750	-1466	
17	Tarifat e shërbimeve që kryhen nga Struktura e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin.	364	11	-353	164	58	-106	
18	Interesa kamatvonesa,taksat	532	175	-357	164	609	445	
19	Detyrimi i prapambetur nga taksat	4000	5568	1568	3,700	13327	9627	
	Shuma	16304	9676	-6628	16534	24903	8369	150.6
	Tarifa ne sektorin e pyjeve dhe kullotave			0				
1	Tarifa ne Sektorin e Pyjeve	4000	5353	1353	4000	5136	1136	
2	Tarifa ne Sektorin e Kullotave	100	0	-100	104	0	-104	
3	Tarifa nga shfrytezimi i materialit drusor nga subjektet	6800	11340	4540	6900	7534	634	
4	Nga shfrytezimi I druve te zjarrit nga fshataresia	1832	610	-1222	1800	971	-829	
5	Nga shfrytezimi I prodhimeve te dyta pyjore, te tjera .	92	0	-92	80	14	-66	
6	Te ardhura nga perdorimi vertetimeve te transportit ,kamate vonese dok. Ankandi rap teknik etj	180	172	-8	200	27	-173	
7	Te ardhura nga shitja e materialit drusor qe dalin nga rrallimet	32	0	-32	48	0	-48	
	Shuma	13036	17475	4439	13132	13682	550	104
	Te ardhura te tjera							
1	Qera e shitje trualli	160	10	-150	164	4	-160	
2	Qera ndertese	376	572	196	120	133	13	
3	Pagesa e prinderve çerdhe	530	437	-93	400	470	70	
4	Pagesa e prinderve kopesht	1532	1441	-91	1276	1792	516	
5	Detyr.te prapamb.nga kopshtet cerdhe dhe qendra ditore	332	0	-332	332	0	-332	

7	Gjoha nga I.N.U.V, policia	664	30	-634	664	170	-494	
9	Te ardhura nga pullat e gjendjes civile 5 %	16	16	0	20	18	-2	
10	Sponsorizime	0	66	66	0	420	420	
11	Te ardhurat nga shitja ,tarifa akte administrative	0	1095	1095	0	0	0	
	Shuma	3610	3667	57	2976	3007	31	101.0
	TOTALI	48,180	42,384	(5,796)	48,843	53,571	4,728	110

Sipas tabelës krahasuese kemi :

Te ardhurat per 4 mujorin e pare 2022 nga **taksat vendore** jane realizuar ne masen 74%

Te ardhurat per 4 mujorin e pare 2022 nga **tarifat vendore** jane realizuar ne masen 151%

Te ardhurat per 4 mujorin e pare 2022 nga **sektori i pyjeve** dhe kullotave, jane realizuar ne masen 104 %

Te ardhura per 4 mujorin e pare 2022 te tjera jane realizuar 101 % .

Sipas Tabelës nr. 1 po japim shpjegimet per cdo realizim , mos realizim te planit te te ardhurave dhe konkretisht :

Taksat e tarifave jane realizuar si me poshte :

- Tatimi i thjeshtuar mbi biznesin, kjo takse xhirohet nga Drejtoria Rajonale e Tatim Taksave dhe eshte realizuar 17.5 %
- Taksa mbi te ardhurat personale, xhirohet per llogari te Bashkise nga Drejtoria Rajonale e Tatim Taksave 2% dhe per 4 mujorin e pare 2022 nuk eshte xhiruar asnje vlere . Nga informacioni qe eshte marre nga DRTT Elbasan xhirimi i takses mbi te ardhurat personale nuk eshte bere per arsye fondesh .
- Taksa e ndertesës eshte realizuar ne masen 54.5 % e planit .Eshte bere nje pune e madhe ne informimin e subjekteve , familjareve per taksen e ndertesës dhe interesi ka qene i madh per te saktësuar llojin dhe siperfaqen per taksim.Gjithashtu eshte dorezuar nga drejtoria e te ardhurave vendore ne 6 njesite Administrative rregjistrat i tatimpaguesve familjare per cdo familje ku identifikimi i ndertesave dhe informacioni nuk ka qene i plote . Ky regjistër per tatimpaguesit familjare i kodifikuar eshte nje ndihme ne identifikimin e cdo familje per cdo takse e tarife .
- Takse mbi truallin eshte realizuar ne masen mbi 100 % planit.Kjo takse eshte per truallin funksional perjashtuar truallin njolle nen ndertese . Specialisteve te njësive Administrative ju eshte dhene ndihma e duhur e qartësuar ligjet ,VKM per te gjetur zbatim sa me te sakte ne llogaritjen e taksave dhe te tarifave .
- Takse toke bujqësore 63.3 % realizim , (eshte ne proces per plotësimin e regjistratit te tatimpaguesve per cdo familje).
- Kalim drejte pronësie nuk eshte realizuar pasi nuk ka patur shitje te ndertesave , nga subjektet juridike firmat e ndertimit. Planifikimi eshte bere mbi numrin e apartamenteve /njësive qe jane per transaksion e per tu shitur.
- Taksa e ndikimit ne infrastrukture ndertimet e reja ,(sektori urbanistikës) eshte realizuar ne masen 42.5 % e planit 4 mujor 2022 . Mos realizimi ka ardhur pasi nuk ka kërkesa per marrje leje ndertimi .

- Taksa e ndikimit ne infrastrukture legalizimet eshte realizuar ne masen 69.6 % e planit 4 mujor .Nga Drejtoria e te Ardhurave Vendore jane kryer njoftimet per cdo person , dosje e te cilit vjen zyrtarisht nga ASHK – ja , por kemi mungese te arketimeve pasi ne momentin qe merret certifikata e pronesise nuk kerkohet vertetimi i pageses se takses se ndikimit ne infrastrukture . Jane afishuar listat emerore te personave debitore, prane Bashkise Librazhd jane derguar lista emerore tek Agjensia Shtetore e Kadastrës Librazhd etj ,per ti vene ne dijeni ne lidhje per taksen e ndikimit ne infrastrukture .
- Taksa e tabelës eshte realizuar ne masen mbi 100 % e planit.Takse table paguajne institucionet dhe subjektet private sipas ligjit dhe siperfaqes qe ata kane , verifikuar kjo nga komisioni i ngritur per matjen e tabelave , reklamave te ndryshme.
- Takse Hoteli eshte realizuar ne masen 42.5 % e planit 4 mujor .Tek subjektet qe paguajne take hotele jane marre regjistrat e nje viti me pare ku jane te deklaruar numri i personave dhe eshte bere taksimi per vitin fiskal.
- Taksa e regjistrimit te mjeteve eshte tejkualuar pasi per nje planifikim me te sakte duhet nje database per te gjitha makinat qe jane ne Bashkine Librazhd gje te cilen e kemi kerkuar prane DRTRR Elbasan dhe nuk eshte marre informacioni ,gje qe reflekton me tejkualim te planit per te cilen do te paraqesim per miratim shtese plani ne taksen e regjistrimit te mjeteve .DRTRR xhiron 25 % e vleres per llogari te Bashkise .
- Te ardhura nga Renta eshte realizuar ne masen 70.6 % e planit 4 mujor 2022 nga subjektet minerare qe jane ne juridiksionin e Bashkise .
- Taksa e perkohshme e e permiresimit te infrastructures rrugore eshte realizuar ne masen 74.8 % e planit 4 mujor 2022 .Subjektet qe paguajne jane institucionet shtetore e jo shtetore , bankat , fondacionet , subjekte prodhuese te energjise .

Pra sa me lart realizimi nga taksat vendore eshte ne masen 73.9 %

- Tarifa e pastrimit eshte realizuar ne masen 68.53 % .Per sa i perket tarifes se pastrimit qe paguajne familjaret pagesa e tyre eshte shtrire ne muajt Maj – Gusht dhe nuk pasqyrohet ne periodhen e karetmujorit pare 2022 . Per sherbimin e dhene nga bashkia si per familjaret ashtu edhe subjektet private ,institucionet ,eshte bere nje pune shume e madhe ne informimin dhe ne sensibilizimin, efektin per pagesat e kryera nga ana e tyre dhe ndikimi ne mjedis qe i sherben komunitetit ne mirqenie dhe ne mbajtjen paster te qytetit. Jane informuar bizneset ne njesite administrative per tarifen e pastrimit jane paisur me kosha dhe ndergjegjesuar per pagesen e kesaj tarife.
- Tarife ndricim gjelberimi eshte realizuar ne masen 49.55 % ,familjaret ,si per tarifen e pastrimit ashtu dhe ndricim gjelberimit eshte shtrire per te vjele ne muajt Maj – Gusht 2022.
- Tarife sherbimi ne varrezat publike nuk eshte realizuar . Kete tarife e paguajne dy subjekte te cilet jane te licensuar per sherbime funerale .
- Tarifen e sherbimit veterinar e paguan subjekti i thertores sipas numrit te krereve , te imta dhe te trashe te cilat mbahen ne nje rregjister te vecante . ku ne Bashkine Librazhd eshte nje subjekt qe ushtron aktivitet te tille . Per 4 mujorin e pare viti 2022 nuk eshte arketuar .

- Tarife e tregut te organizuar , realizuar ne masen 63.9 % sipas kontratave , arketime nga biletat .Per vitin 2022 jane lidhur 27 nr i kontratave te lidhura deri 30.04.2022 me tregtaret ne tregun e qytetit. Jane sistemuar te gjithë tregtaret ambulante brenda ne treg dhe taksimi sipas percaktimeve dhe tarifave te miratuar ne Keshillin Bashkiak. Krahasuar me nje vit me pare kemi ulje te numrit te kontratave te tregtareve ne tregun e qytetit, gje e cila ka ndikuar jo pozitivisht ne te ardhurat qe vijne nga tregu.
- Tarife parkimi eshte realizuar ne masen 49 % e planit 4 mujor 2022.Tarifen e parkimit e paguajne te gjitha subjektet private te cilet jane te licensuar dhe kane te rregjistruar ne QKB targen e mjetit per qellime te aktivitetit te tyre .
- Tarife per dhenie license e certificate transporti eshte realizuar ne masen mbi 100 % pasi subjektet kane bere pagesen e taksave bashke me licensen brenda 4 mujorit te pare 2022 .Subjektet e transportit rreth qytetas paisen nga bashkia me license e certificate transporti .Te gjitha subjektet private qe jane paisur me license nga bashkia jane miratuar ne Keshillin Bashkiak , dhe konfirmuar ne Prefekturen e qarkut Elbasan Ne Licensen qe marrin subjektet nga Bashkia jane te percaktuara linjat dhe oraret per linjat rrethqytetase te miratuar ne VKB dhe ne Qark .Jane futur ne regjistrin e biznesit te gjitha subjektet e licensuara .Cdo subjekt qe licensohet nga Bashkia ne momentin e marrjes se saj ploteson te gjithë dokumentacioni e duhur te fotokopjuara dhe te noterizuara te cilat ruhen bashkelidhur licenses ose çertifikates se transportit . Aktualisht jane te miratuara 30 linja rrethqytetase per 6 njesite administrative me orare kthimi e nisje te percaktuara te miratuara ne Keshillin Bashkiak dhe konfirmim ne Prefekturen e Qarkut Elbasan .
- Tarife per leje te drejta , vertetime , informacione eshte realizuar ne masen 20 %.Tarife nga vertetimet paguhet nga individe per kolaudim dhe subjekte biznesi, si vertetim per detyrime ose jo , ushtrim aktiviteti ose jo . Vertetimi per invalidet , ndihme ekonomike jepet pa pagese , nuk e paguajne sherbimin kjo ne zbatim te paketes fiskale viti 2022 .
- Tarifa per zenien e hapësirave publike nuk eshte realizuar .
- Tarife per librat e udhetimit te udhetareve brenda vendit . Librat e udhetimit merren me kerkesen e subjekteve te transportit per linjat rrethqytetase te cilet i perdorin kur dalin jashte linjave te percaktuara ne license e certificate transporti . Blloqet e udhetimit nuk jane marre nga subjektet e transportit pasi ka qene situata e pandemise, mungesa e popullsise dhe levizjet jashte bashkise kane qene te pakta .
- Tarife per autorizime , ushtrim aktiviteti , autorizime per karburantet eshte realizuar dhe tejkualuar per arsye se subjekte ne tregtimin e karburanteve , vajrave lubrifikante etj ne momentin e marrjes se Licenses / autorizimit nga bashkia nga viti 2017 – 2021 kane difference ne likujdim nga interpretimi i gabuar i baze ligjore (rekomadim i Klsh) dhe nga njoftimet per pagese te detyrimit kane likujduar dhe jane ne proces per mbylljen e detyrimit te gjitha subjekte e licensuar per kete lloj aktiviteti .
- Tarife per linjat ajrore e nentokesore nuk ka paguar asnje subjekt per 4 mujorin e pare 2022 . Kete tarife e paguajne subjektet qe ushtrojne aktivitet ne fushen e transmetimit televizive , internet , kablllore, fibra optike Jane marre te dhena tek AKEPI dhe AMA per numrin e abonenteve qe ka

secili subjekt privat i rregjistruar .Ne Bashkine Librazhd jane 4 subjekte qe ushtrojne aktivitet ne fushen e transmetimit televizive , internet kabllor etj .

- Tarife per mbetjet inerte eshte realizuar ne masen 51.5 % e planit vjetor, Jane subjekte qe qe kryejne punime e transportojne mbetje inerte ne venddepozitimet e percaktuara me VKB .
- Tarifa per ndikimin ne mjedis eshte realizuar ne masen 33.8 % e planit,taksa e ndikimit ne mjedis arketohet nga subjektet shfrytezimi minerar , prodhim energjie , dhe subjektet ne fushen e hidrokarbureve .
- Tarifat e sherbimit nga struktura e mbrojtjes nga zjarri e shpetimi (te ardhurat nga NMPZ) jane realizuar ne masen 35 % e planit 4 mujorit pare 2022 .
- Gjjobat(interesa kamate vonesat) jane realizuar ne masen mbi 100% e planit , jane llogaritur sipas ligjit ne fuqi mbas afatit zyrtar llog 0.06 % ne dite mbi detyrimin deri me 365 dite, dhe per kontratat ashtu si percaktohet 0.01 % ne dite .
- Detyrimet e prapambetura nga taksat jane tejkualuar, jane realizuar mbi 100 % e planit , kjo per faktin se eshte ndjekur dhe zbatuar Ligji nr. 9920 date 19.05.1998 “ Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise si:
 - * i masave shtrenguese ,
 - * kerkese per pagese per disa vite te detyrimeve nga subjektet e biznesit madh dhe te vogel
 - * interes nga subjektet per pagese me keste te detyrimeve te prapambetura jane arketuar detyrimet nga subjekte te licensuara dhe te pa tarifuar per disa vite me pare dhe nje pjese e mire e bizneseve jane ndergjegjesuar per detyrimet, si dhe per taksen e ndikimit ne infrastructure /legalizimet ,jane arketuar nga familjaret detyrimet e prapambetura te xhiruara nga ujesjellesi mbas njoftimit per pagese te derguar nga Drejtoria e te Ardhurave Vendore , zyra e taksave ,per detyrimin ndaj Bashkise .
- Te ardhurat ne sektorin e pyjeve dhe te kullotave eshte realizuar ne masen 104 % e planit qe ka te beje tarifate ne sektorin pyjor , kullosor , prodhimet e dyta , te ardhura nga rrallimet si dhe me kontratat e lidhura me subjektet dhe bashkine per shfrytezimin e materialit drusor.
- Qera e shitje trualli nuk eshte realizuar .
- Qera ndertese eshte realizuar ne masen mbi 100 % e planit ku jane kontrata e lidhura me Bashkine dhe familjaret (privatizimi i banesave) .
- Pagesat e prinderve per cerdhe ,pagesat e prinderve per kopesht , detyrimet te prapambetura cerdhe kopesht qendra ditore eshte realizuar plani 4 mujorit pare 2022 .
- Gjjoba nga INUV , policia eshte realizuar ne masen 25.6 % .
- Te ardhura nga pullat jane realizuar 90 % e planit te 4 mujorit te pare 2022.

- **Persa i perket numrit te subjekteve / bizneseve nga të dhënat e paraqitura rezulton se për periudhën 2020 , 2021** subjekte që kanë ushtruar aktivitet dhe për të cilat janë planifikuar taksa dhe tarifa vendore, paraqiten në pasqyrën si më poshtë.

Lloji i Biznesit	Paraqitja e numrit te bizneseve			Per vitin 2022
	Gjendja 31.12.2021	Biznese të reja gjate 4-mujorit te pare 2022	Biznese të mbyllura, pezulluara gjate 4-mujorit te pare 2022	Gjendja me 30.04.2022
B. Vogël	633	8	27	614
B. Madh	127	3	3	127
Institucione	41	0	0	41
Gjithsej	801	11	30	782

Subjekte te hapura per 4 mujorin e pare ne vitin 2022 jane 11 .

Subjekte te mbyllura per 4 mujorin e pare ne vitin 2022 jane 30.

Subjekte te reja biznes i madh jane 3 subjekte.

1- HOLI-2021

2- Toci shpk

3- Rosi Construction "Shefki Doma "

Subjekte e biznesit te madh jane mbyllur 3;

1-Nebi Cota

2- Perparim Haskurti

3-Kevuci

Subjekte te mbyllura per 4 mujorin e pare ne vitin 2022 jane 30 te cilet i kane pezulluar dhe rregjistruar . Per bizneset e pezulluara nga Drejtoria e te Ardhurave Vendore jane marre masat per verifikimin ne terren per ushtrim ose jo aktiviteti privat dhe ne rast se kostatohen raste mbahet konstatime dhe taksohen e tarifohen sipas llojit te aktivitetit dhe dergohet njoftim DRTT Elbasan .

Gjendja e bizneseve aktive deri me 30.04.2022 jane 782 subjekte .

Cdo dite vazhdon puna ne terren per identifikimin dhe informalizimin e bizneseve duke i orientuar dhe duke i futur ne rregjistrin e biznesit te Bashkise .Nje ndihme ka qene dhe bashkepunimi me DRTT Elbasan per ndarjen e pergjegjesise tatimore per cdo biznes. Gjithashtu dhe bashkepunimi me Policine Bashkiake ka qene nje ndihme per kordinimin dhe per ecurine e punes si ne lidhje me subjektet e palicensuara , tregtare ambulatore , sistemimin e tregtareve ne tregun e qytetit .

Per objektet e legalizuara .

Per te gjitha dosjet e ardhura nga aluizni (ASHK) jane bere llogaritjet per cdo m2 siperfaqe , per cdo pronar ku ndodhet pasuria e lloji i pasurise dhe numri i objektit qe legalizon.

Numri total i objekteve te legalizuara per 4 mujorin e pare ne vitin 2022 nga ASHK Elbasan kane ardhur 25 dosje objekte te legalizuara me vlere te llogaritur 938 mije leke .

Per 4 mujorin e pare ne vitin 2022 jane arketuar 29 dosje objekte legalizimi me vlere 813 mije leke sipas % e llojit te nderteses percaktuar me VKM e VKB.

Gjendja 31.12.2021 dosje 263+ 25 dosje ne 4 mujorin e pare viti 2022 = 288 dosje /objekte legalizimi ,ose ne leke (9,593 mije + 938 mije leke = 10,531 mije – 813 mije pagesa = 9,718 mije leke me 30.04.2022) Per 4 mujorin e pare te vitit 2022 kane ardhur 25 dosje objekt legalizimi me vleren 938 mije nga keto 9 jane paguar ne vleren 251 mije leke .

Ne total debitorët 2016 - 2022 jane 259 dosje /objekte legalizimime vlere 9,718 mije leke deri me 31.04.2022 pa u arketuar per llogari te Bashkise .

Nr	Gjendja me 01.01.2022		Dosje te hyra viti 2022		Pagesa te kryera viti 2022		Gjendje me 30.04.2022 Subjekte debitoare	
	Nr dosje	Vlera /000	Nr dosje	Vlera /000	Nr dosje	Vlera /000	Nr dosje	Vlera /000
2	263	9,593	25	938	29	813	259	9,718

Numri dhe vlere e debitoreve eshte me e madhe pasi ne ASHK , aktin /certifikaten e pronesise pronaret i terheqin dhe pa e paguar taksen e ndikimit ne infrastrukture te legalizimit te cilen nuk e pengon pronarin te terheqe certifikaten e pronesise nga ndryshimi i ligjit 9632 date 30.10.2006 me Ligjin 98/

2020.Pamvaresisht masave qe jane marre si njoftim per pagese ne momentin qe vjen dosja e legalizimit ne bashki , njoftim vleresimi etj, kemi nje renie te pagesave te kryera kjo dhe per faktin e ndryshimit te ligjit . Per dosjet e ardhura nga ASHK ne momentin qe kryhet pagesa nga qytetaret e subjektet njoftohet zyrtarish ASHK Librazhd dhe ASHK Elbasan per pagese te takses se ndikimit ne infrastrukture .

Eshte plotesuar e permiresuar rregjistri elektronik i biznesit me te dhenat perkatese duke marre informacion nga Drejtoria Rajonale e Tatim Taksave Elbasan per llojin e biznesit ,i madh, i vogel , vazhdon plotesimi me te dhenat ID ,certificate rregjistrimine QKB , certificate pronesie , kontrate qeraje etj.

Eshte bere nje pune e mire ne lidhje me disa biznese te medha qe prej vitesh ishin debitore dhe sot jane ne vijueshmeri te mire me pagesat qe kryhen nga ana e tyre ,duke lidhur dhe marreveshje per pagese me keste ne zbatim te ligjit 9920 date 19.05.2008 “ Per Procedurat tatimore ne RSH”.

Taksat e Tarifat vendore per familjaret ne qytet mblidhen nepermjet Ujesjelles sh.a Kanalizimeve.

Per vitin 2022 eshte pergatitur kontrata (akt marreveshja) me Ujësjiellësin sh.a Librazhd si agjent tatimor për arkëtimin e taksave e tarifave vendore per abonente familjarë se bashku me faturën e ujit pijshëm.

Per vjeljen e detyrimeve familjare per vitin 2022 per taksa e tarifa vendore jane pergatitur listat dhe jane derguar tek agjenti tatimor sha.Ujesjalles Kanalizime sipas akt marreveshjes se lidhur Bashkia Librazhd me SH A Ujesjelles Librazhd me shkrese Nr 1322 prot date 16.03.2022 e Nr. 49 prot date 30.03.2022 te sh.a ujesjelles, me nr 2525 familje me vlere 7,855,604 leke .Detyrimet per taksa e tarifa vendore per familjaret i kemi sistemuar dhe llogaritur sipas paketes fiskale dhe Ligjit ne fuqi dhe statusit te cdo kryefamiljari .

Debitore familjare per taksa e tarifa vendore qe vilen nga Ujesjelles Kanalizime deri 31.12.2021 jane ne vleren 3,584,751 leke (detyrime te prapambetura nga viti 2011-2021).

Detyrimet per taksa e tarifa vendore nga familjaret per vitin 2022 jane 7,855,604 leke.

Vlera debitore 3,584,751 + Detyrimi i vitit 2022eshte 7,855,604 = 11,440,355 leke (akt- rakordimit 30.04.2022.) Detyriet e prapambetura dhe detyrimi i vitit 2022 do te vilet nga sh.a Ujesjelles Kanalizime per 4 muaj arketime Maj –Gusht 2022.

Ne lidhje me debitoret per taksa e tarifa vendore nder vite .

Detyrimet e prapambetura deri me 31.12.2021 jane **97,568** mije leke ku perfshihen detyrimet biznesi i madh, i vogel , ndertesat , legalizimet ,6 Njesite Administrative , familjaret .

Vlera debitore qe eshte arketuar gjate 4- mujorit pare 2022 eshte 13,327 mije mije leke nga 11,000 mije leke te planifikuara .

Për të gjitha detyrimet tatimore të pa mbledhura ndaj subjekteve eshte kryer procedura e mbledhjes me force e detyrimeve,ku procedura e pare eshte njoftim vleresimi ,për biznesin e madh, biznesin e vogel, legalizimi, tregu , ndertesat,kjo ne zbatim te Ligjit Nr.9920, datë 19.5.2008 “ Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise “ ndryshuar neni 88 , neni 89 neni 90 neni 91.Jane derguar njoftim vlersimeve per te gjithë debitoret Numri total i njoftim vleresimit per detyrimet e prapambetura per biznesin e madh eshte 78 subjekte me vlere me vlere 32,933 mije leke .

Numri total i njoftim vleresimit per detyrimet e prapambetura per biznesin e vogel , ndertesat eshte 416 subjekte 18,324 mije leke.

Numri total i tregtareve ne tregun e qytetit me nr 110 me vleren 3,909 mije leke

Numri total i objekteve te legalizuar me nr 263 me vlere 9,593 mije leke.

Nr total i njoftim vleresimeve per detyrimin e prapambetur eshte 494 ne vleren 51,257 mije leke .

Mbas njoftim vleresimit per subjektet debitore eshte kryer procedura e ;

-bllokimit te llogarive bankare per biznesin ne madh sipas shkreses me Nr 644.Prot date 09.02.2022,

- barre hipotekore me Nr.691 date 14.02.2022

-barre sigures mjete me Nr 690 date 14.02.2022

Gjendja e debitoreve me 30.04.2022 per subjektet biz madh , I vogel , ndertesa me qera etj eshte 34,727 mije leke

-Per debitoret e Njesive Administrative jane derguar njoftim detyrimi te vitit fiskal dhe te prapambetura ne nje njesi administrative (njesia ad. Qender).

Theksojme faktin se shume subjekte debitore qe kane mbetur nder vite jane subjekte te cilet kane mbyllur aktivitetin , jane larguar , kane nderruar jete etj . Gjithashtu jane detyrime per taksen e nderteses ku cdo dite po punohet ,verifikohen prona dhe regjistrohen ne regjistrin e taksave per te bere te mundur zbatimin e VKM 132 date 07.03.2018 “ Per Metodologjine per percaktimin e vleres se taksueshme te pasurise se paluajtshme “ Ndertesa “ ... per vleresimin alternative te detyrimit te takses.

Per regjistrimin e ndertesave dhe taksimin e tyre krahasimi duket si me poshte ;

Per vitin 2022 , grupet e ngritura me urdher Nr 27 date 12.01.2022 te titullarit te Bashkise “ Per verifikimin e Informacionit ne terren per Popullimin e Kadastrës Fiskale “ ,jane bere regjistrimet e tyre ne regjistrin e biznesit dhe te familjeve . Kemi nje shtrirje me te madhe te bazes se taksueshme , krahasuar me vitin 2021.

Per vitin 2021 jane takeluar per takse ndertese nje siperfaqe prej 288 000 m2 ndertese, aktivitet privat dhe apartament banimi .

Per vitin 2022 jane takeluar per takse ndertese nje siperfaqe prej 310 000 m2 ndertesa per aktivitet privat , prodhimi , bodrum dhe apartament banimi .

Vlen te permendet se Sistemi i Kadastrës Fiskale eshte nje ndihme shume e madhe ne verifikimin e te dhenave per cdo pronar te ndertesave dhe taksimin e tyre .Nga Drejtoria e Pergjithshme e Takses se Pasurise eshte shume e domosdoshme qe te kryhen trajnime per ngritjen profesionale te punonjesve.

Ne programin e instaluar hidhen cdo dite te dhena te siperfaqeve te ndertesave , perditesohen te dhenat ne rast transakcioni te pasurive , hidhen te dhena qe merren nga ASHK, ALUIZNI,Gjendje Civile , OSHEE, verifikimi ne terren etj.Nga verifikimet qe behen ne terren per ndertesat , identifikohet dhe hidhen ne regjister por nje pjese e pronareve jane me statusin e pensionistit , ndihmes ekonomike te cilet i perjashton ligji per pagese .

Qellimi i hedhjes se ketyre te dhenave eshte identifikimi , regjistrimi i cdo siperfaqe ndertese e cila ndikon ne rritjen dhe zgjerimin e baze se taksueshme .

Per vitin 2022 , 2021 , shkalla e takses per njesi sherbimi e miratuar dhe aplikuar eshte 0.24 %

Per vitin 2022 , 2021 shkalla e takses per banim e miratuar dhe aplikuar eshte 0.035%

Per vitin 2022 numri i njesive pronesore te perjashtuara eshte 288 familje pensioniste dhe ndihme ekonomike me nje siperfaqe 20856 m2

Per vitin 2021 numri i njesive pronesore te perjashtuara eshte 251 familje pensioniste dhe ndihme ekonomike me nje siperfaqe 20919 m2.

Ne kuader te bashkepunimit me projektin Bashki te forta kemi bere te mundur realizimin e regjistrimit unik dhe te kodifikuar per familjaret ne 6 njesite administrative si dhe marrja e informacionit ne baze te gjendjes civile per gjendjen familjare per te gjithë Bashkine me te dhena si kryefamiljari ,nr i personave ,datelindja adresa , nr tel etj

Gjendja e debitoreve te tregut.

Me 31.12.2021 vlere debitore per tregun e qytetit ka qene 3,909 mije leke,detyrimi per 4 mujorin 2022 sipas kontratave 158 mije leke,(3909+158=4,067 mije leke , jane arketuar 111 mije leke .Me 30.04.2022 gjendja debitore 3,956 mije leke plus jane arketuar nga biletat 196 mije leke , ne total jane arketuar 307 mije leke .Jane kryer kontrole ne disa subjekte ne bashkepunim me Policine Bashkiake , ne tregun e qytetit jane bere sistemime , vizime ku te gjithë subjektet te tregtojne brenda hapsires se tregut.

Persa i perket 6 Njesive Administrative per vitin 2022 rezulton se :

Nr	Njesia Administrative	Plani vjetor 2022	Fakti 4 mujor	Diferenca mos realizim
1	Njesia administrative Hotolisht	7,517,000	890,956	6,626,044
2	Njesia administrative Polis	1,813,000	28,896	1,784,104
3	Njesia administrative Orenje	1,255,000	344,094	910,906

4	Njesia administrative Lunik	1,999,000	546,520	1,452,480
5	Njesia administrative Stebleve	505,000	55,169	449,831
6	Njesia administrative Qender	4,184,000	1,240,537	2,943,463
	SHUMA	17,273,000	3,106,172	14,166,828

Nr	Njesia Administrative	Plani 4- mujor 2022	Fakti 4 mujor 2022	% realizimit
1	Njesia administrative Hotolisht	2,505,000	890,956	35.5%
2	Njesia administrative Polis	604,333	28,896	4%
3	Njesia administrative Orenje	418,333	344,094	82.2%
4	Njesia administrative Lunik	666,333	546,520	82%
5	Njesia administrative Stebleve	168,333	55,169	32.7%
6	Njesia administrative Qender	1,394,666	1,240,537	88.9%

Nr	Njesia	% realizimit e planit vjetor
1	Njesia administrative Hotolisht	12 %
2	Njesia administrative Polis	2 %
3	Njesia administrative Orenje	27%
4	Njesia administrative Lunik	28.8%
5	Njesia administrative Stebleve	10.9%
6	Njesia administrative Qender	29.6%

Siç shihet disa nga Njesite Administrative jane ne nivel te ulet te mbledhjes se te ardhurave vendore si ne detyrimin e vitit fiskal ashtu dhe te detyrimeve te prapambetura .Pamvaresisht se jane informuar , orientuar , ndihmuar me formulare , baze ligjore , shkresa per te qene sa me kontakt te cdo problemi, perseri rezultojne me mos realizim te te ardhurave dhe pasaktesi ne raportime .

Me gjithë punën e kryer dhe perkushtimin qe ka Drejtoria e te Ardhurave Vendore , ka mangesi dhe problematika per tu permiresuar e per te ecur perpara ne realizimin e objektivave.

Per kete jane identifikuar disa rrisqe qe ndikojne ne realizimin e tyre qe mund te permendim;

Faktorin Risk si :

- 1- Ngritja e kapaciteteve profesionale te stafit vecanerisht ne gjashte njesite administrative .
- 2- Debitoret nder vite .
- 3- Trajnime te punonjesve te taksave dhe tarifave vendore .
- 4- Informacioni nga ASHK(Agjensia Shtetore e Kadastres)per regjistrimet dhe legalizimet.

- 5- Informalizimi i sipërfaqes së ndërtesave .
- 6- Infomalizimi i bizneseve në vazhdimësi .
- 7- Bashkëpunimi me Policinë Bashkiake .
- 8- Parkimi ditor në zonat me potencial më të madh .

H A R T O I
DREJTORE E TË ARDHURAVE VENDORE
LINDITA SHULI

Librazhd më , 20.02.2022